

ISLAMIKËT JAPIN 125 MILIONË USD PËR RRUGËN QUKËS-QAFË PLOÇË

## Finalizohet studimi, në verë rinisin punimet në rrugën Qukës - Qafë Ploçë

**B**anka Islamike për Zhvillim miratoi financimin në masën 125 milionë dollarë për segmentin e ri të rrugëve nacionale: Qukës- Qafë Ploçë. ë mbledhjen e tij të datës 13 shkurt, Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) ka vendosur që, ndër financimet e tjera, të përfshihet edhe një financim për buxhetin e shtetit shqiptar në masën 125 milionë dollarë për ndërtimin e këtij segmenti, që është pjesë e rrugës nacionale nga Elbasani drejt Korçës, duke anashkaluar Pogradecin. (Faqe 2)



**S**e shpejti, Shqipërisë do t'i shtohet edhe një segment shume i rendesishem infrastrukturor. Vendi ku kalon rruga e re nga Qukes deri ne Qafe Ploçe ne Pogradec përfaqëson distancën me te shkurter per gjithe qarkullimin qe do te shkoje nga Shqiperia perendimore ne drejtim te Korces dhe te Greqise. Kjo rruge sherben per te lidhur pjesen Lindore te vendit me pjeset e tjera. Ajo eshte rruga kryesore qe do te ndertohej nga Qukes deri ne Ploçe. Rruga fillon ne Qukes dhe mbaron ne Qafe Ploçe. Zona eshte me relief kodrinor malor ajo



### Në ditëlindjen e librit "Heremit" të Bujar Balliut

Cila është ditëlindja e një libri? Kur autori mbyll gjithçka dhe e nis për botim, kur del në treg, apo kur pranohet "zyrtarisht" prej lexuesit? Ndoshta kjo e fundit, më e zhurmshme.

**Zako Spirollari, bir i Pleshishtit dhe i Mokrës** Nga Dhimitër GEGPRIFTI

**DEMIR ELEZI, PUNETOR E I PALODHUR**

Nga Sami LEKA

**Nurie Biba, nëna e paharruar mokrare** Nga Petrit BUNA



Me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Çetës partizane të Mokrës (mars 1943- 2013)

**KONTRIBUTI I ÇETES SE MOKRËS, ME KOMANDANT RESHIT ÇOLLAKU NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE**

Nga Llazi TONA

Reportazh - Duke udhëtuar nëpër Mokër...

### Lart në Trebinjë, ku çelin lulet mes deborës



" Siç thoshte Gjergji... "

Nga Istref HAXHILLARI



# Finalizohet studimi, në verë rinisin punimet në rrugën Qukës - Qafë Ploçë

## ISLAMIKËT JAPIN 125 MILIONË USD PËR RRUGËN QUKËS-QAFË PLOÇË

Se shpejti, Shqipërisë do t'i shtohet edhe një segment shume i rendesishem infrastrukturor. Vendi ku kalon rruga e re nga Qukes deri ne Qafe Ploçe ne Pogradec përfaqëson distancën me te shkurter per gjithe qarkullimin qe do te shkoje nga Shqiperia perendimore ne drejtim te Korces dhe te Greqise. Kjo rruge sherben per te lidhur pjesen Lindore te vendit me pjeset e tjera. Ajo eshte rruga kryesore qe do te ndertohej nga Qukes deri ne Ploçe. Rruga fillon ne Qukes dhe mbaron ne Qafe Ploçe. Zona eshte me reliev kodrinor malor ajo ndjek luginen e lumit Shkumbin deri ne kilometrin e 19+300 dhe pastaj ne luginën e lumit te Dushes deri ne km 23+000 dhe deri ne fund te rruges ne Qafe Ploçe ngjitet kodrave te Potgozhanit, Dardhasit dhe te Ploçes. Rruga nderpret disa perrenj te vegjel dhe te medhenj. Ne te gjithe perrenjte sipas madhësisë se shtratit dhe sasise se ujit do te projektohen ura te vogla dhe te medha. Ne disa raste do te kete dhe viadukte.

Ne zonen ku kalon ky segment rrugor kemi tre njesi gjeomorfologjike te medha njesia e pare eshte zona e luginës se lumit Shkumbin, njesia e dyte eshte zona e luginës se lumit te Dushes dhe njesia e trete jane kodrat e zones nga Prenjasi deri ne Ploçe.

Aktualisht Autoriteti Shqiptar i Rrugëve ka përfunduar te gjitha punimet, duke përfshire edhe studimin e impaktit mjedisor, duke hapur rrugën per fazen finale te punimeve.

**Karakteristikat e gjurmës së rrugës së re/ Rruga e re do te ndahet ne disa pjese.**

Ne segmentin e pare, ndermjet Km 0,0 dhe Km 10,5 rruga ndodhet ne nje zone te sheshte ndërmjet kuotave 440m dhe 550m mbi nivelin e detit, dhe shtrihet paralel me shtratin e lumit Shkumbin, mbi gjurmen e rruges ekzistuese i shtrire ne nje reliev qe perbehet nga conglomerate dhe rere. Shtresa aluvionale eshte e perbere nga material zhavorri dhe rere. Nga Km 10,5 ne Km 15,9 rruga zhvillohet ne drejtimin V-J, duke ndjekur ne te majte te lumit Shkumbin. Gjeresia dhe thellesia e zones aluvionale fillon te zvogelohej derisa ajo zhduket dhe lumi shkon vete midis kodrave. E njejta gje mund te thuhet per gjurmen e rruges e cila ndjek anen e malit, qe shtrihet ne afersi te shtratit te lumit. Ky terren kodrinor eshte i perbere nga flishi gelqerore. Relievi ne kete zone dominohet nga fraksione litoidi sesa nga ato argjilozë.

Nga km 15, 9 me kuote rreth 580m, deri ne km 22.9 me kuote 1020m mbi nivelin e detit, gjurma e rruges dalengadale rritet ne

*Banka Islamike per Zhvillim miratoi financimin ne masen 125 milionë dollarë per segmentin e ri të rrugëve nacionale: Qukës- Qafë Ploçë. ë mbledhjen e tij të datës 13 shkurt, Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) ka vendosur që, ndër financimet e tjera, të përfshihet edhe një financim për buxhetin e shtetit shqiptar në masën 125 milionë dollarë për ndërtimin e këtij segmenti, që është pjesë e rrugës nacionale nga Elbasani drejt Korçës, duke anashkaluar Pogradecin. Rruga ka mbetur në projekt për disa vjet rresht, duke qënë se nuk janë siguruar dot fonde për financim nga jashtë, ndërkohë që vetë burimet e brendshme të buxhetit kanë qënë të pamjaftueshme për të paguar kompanitë që do të kryejnë punimet. Segmenti kalon mbi Qafë Thanë, pa zbritur në buzë të liqenit të Pogradecit, duke krijuar një lidhje shumë të shkurtër në kohë me Korçën. Së bashku me tunelin e Elbasanit, nga kryeqyteti në Korçë apo në kufirin me Greqinë, në Kapshticë, udhëtimi shkurtohet për më shumë se një orë.*



kuote, duke u ngjitur kodrave perreth, ne formacione ranore te shpatit qe nderthuren me formacione gelqerore. Gjurma largohet nga rruga ekzistuese per te perfituar nje pjerresi gjatesore max 7%. Midis km 23 dhe km 27 (me lartesi mbi nivelin e detit 1030 m), morfologjia zbutet krejtesisht. Ne kete zone ndodhen disa fshatra (Trebijnja, Malina, Kalivaci). Ndersa gjurma ekzistuese kalon mes fshatrave, aksi i ri zhvillohet jashte tyre duke kaluar disa qindra metra larg zones se banuar. Rreth km 28 gjurma e rruges rrit lartesine menjehere duke arritur kuoten max 1325 m, deri ne km 31,9 duke kaluar ne nje zone malore te demtuar, me shpate gerqerore dhe ranore. Pikerishte ne kete zone per te ruajtur pjerresite gjatesore eshte menduar nje tunel midis km 31.5 me gjatesi 375 ml. Pas km 32, gjurma ne drejtim te Qafe Ploçes fillon zbrer ne kuote deri ne km 41.5, lartesia arrin (815m) mbi nivelin e ditit, ne afersi te fshatit Geshtenjas. Gjurma e re e vendosur ne mes te shpateve me formacion gelqeror dhe ranor vecanerisht konsistente. Nga km 41.5, me lartersi 850m mbi nivelin e detit deri ne km 43.3, qe përfaqeson piken lidhese me segmentin e rehabilituar Qafe Ploçe - Korçe, gjurma rrit lartesine ngadale duke arritur ne fund me nje lartesi 875m mbi nivelin e detit.

**Shërbimet publike**

Parimisht, shërbimet kryesore publike do te preken nga projekti. Perkohesisht, gjate periudhes se ndertimit, zhvendosja e ketyre shërbimeve

## Autostrada Tirane-Elbasan drejt përfundimit, edhe pak muaj nga hapja

*Në autostradën Tiranë-Elbasan, makinertë nuk fiken thuajse asnjëherë. Ne tunelin e Kërrabës, pjesën me të rëndësishme të projektit, po vihet sinjalistika. Ne dy segmente e tjera, nga Tirana ne hyrje te tunelit dhe nga dalja e tunelit ne Elbasan, është realizuar mbi 50 % e punimeve. “Punohet 24 orë në ditë, me këto ritme pretendojmë që ne fund të pranverës të filloj operimi. Jemi përqëndruar me shume ne segmentin e trete qe lidhe tunelin me Elbasanin. Ky segment parashikohet te hapet i pari pasi shkurton ndjeshëm distancën”, u shpreh drejtori i projektit te autostradës Tirane-Elbasan, Skënder Cota. Segmenti nga dalja e tunelit deri ne Elbasan pritet te hapet me shpejt se pjesa tjetër. Sfidë për inxhinieret janë veprat e artit. Po ndërtohen 10 ura, secila unike ne forme dhe përmasa, ndërsa në veprat e artit ka përfunduar mbi 70 për qind e punimeve. Ne projekt janë parashikuar te ndërtohen dhe te gjitha nyjet hyrëse dhe dalëse qe lidhin rrugën me fshatrat përreth. “E gjithë autostrada do jete e rrethuar me rrjete për ta bërë me te sigurte kalimin, janë ndërtuar te gjitha rrugët lidhesh me fshatrat. Është parashikuar rikonstrukcioni total i rrugës se vjetër, shtrimi, sinjalistika, ndarjet anësor etj”, u shpreh Cota. Autostrada Tirane- Elbasan do jete e gjate 27 kilometra. Me përfundimin e saj, distanca midis kryeqytetit dhe Elbasanit pritet te shkurtohet më shume se 50 % dhe koha e udhëtimit mendohet te jete rreth 25 minuta.*

mund te krijoje problem per perdoruesit. Keto problem mund te prekin me shume perdorues gjate procesit te lidhjes se kabllove dhe tubave te rinj me rrjetin ekzistues te perdoruesve pergjate rruges ekzistuese.

Ne keto raste, kontraktori duhet te pergatise nje plan te detajuar veprimi perpara cdo aktiviteti ne terren. Ky plan duhet te parashikojë akomodimin dhe mbrojtjen e gjithe shërbimeve publike qe gjenden ne zonen e ndertimit, sic jane kabllot elektrike dhe te telefonise, tubacionet e ujesjellesit, kabllot e ndricimit rrugor apo struktura te tjera qe mund te rezultojne pas nje inspektimi ne terren. Kontraktori duhet te koordinoje aktivitetet me ndermarrjet pergjegjese, te cilat kane prone-

sine e ketyre rrjeteve, sic jane Al-telecom, KESH (Korporata Elektroenergjitike) dhe Ndermarrja e Ujesjellesit, me qellim reduktimin e mundesise se demtimit dhe te kohes se kryerjes se lidhjeve te reja me rrjetin ekzistues. Ky plan duhet te rishikohet fillimisht nga Inxhinieri Supervizor dhe kontraktori duhet te filloje zbatimin pas miratimit përfundimtar nga Ponedhensia.

**Popullsia**

Pergjate kesaj rruge ka popullsia dhe aktivitet te konsiderueshem. Deri ne njefare mase rruga do te coje ne permiresimin e kushteve ekonomike, jo vetem per banoret pergjate rruges ekzistuese, por edhe per distancën me te shkurter per

gjithe qarkullimin qe do te shkoje nga Shqiperia perendimore ne drejtim te Korces dhe te Greqise. Kjo rruge sherben per te lidhur pjesen Lindore te vendit me pjeset e tjera. Ajo eshte rruga kryesore qe do te ndertohet nga Qukes deri ne Ploçe.

**Ndikimet në aktivitetin ekonomik**

Skema e propozuar mund te pritet qe te coje ne rritjen e zhvillimit rezidencial dhe komercial prane rruges se re. megjithese, brenda kuadrit te ketij VNM-je, nje vleresim i ndikimeve te detyruara eshte i pamundur, nga eksperienca e kaluar e ndertimit te rrugëve te reja ne Shqiperi, ka shume te ngjare qe menjehere pas përfundimit te rruges do te kete nje rritje te ndertimeve te reja, legale dhe ilegale, prane rruges se re. te gjitha rrugët e reja qe jane ndertuar deri tani kane perjetuar kete forme te ndertimeve te paplanifikuara. Llojet e ndertimeve variojne nga stacionet e karburanteve, tek baret/restaurantet, varrezat e makinave, dyqanet/kioskët dhe shëpëte. Çdo ndertim tenton te kete aksesin e vet tek rruga e re, duke rritur kështu rrezikun e aksidenteve dhe duke reduktuar sigurine e pergjithshme te rruges.

Nese ndertimi behet ne zonen e mbrojtur toke, rruga mund te kete nje ndikim te moderuar mbi kete burim. Nderkohe qe rregulloret e planifikimit jane te disponueshme per te kontrolluar kete lloj ndertimi, shpesh ato nuk zbatohen. Keshtu qe do te jete thelbesore per Autoritetet Planifikuese qe te zbatojne me rigorozitet rregulloret per kontrollin e planifikimit, me qellim qe te sigurojne se toka perreth rruges se propozuar nuk grabitet prej ndertimeve te paplanifikuara.

Zbatim me rigorozitet kerkohet gjithashtu edhe per mbrojtjen e tokes dhe parandalimin qe faktit qe skema mund te coje ne rritje te prerjes pa lisenca te pemeve, marrjen e gureve apo grumbullimin ilegal te mbeturinave pergjate rruges.

Shfrytëzimi i rruges pritet qe te kete nje efekt te rendesishem perfitues mbi ekonomine e zones, permes rritjes se aksesit tek tregjet, shtimit te prodhimit bujqesor dhe perpunimit dytesor te materialeve, rritjes se turizmit dhe shërbimeve qe lidhen me te, duke cuar ne nje rritje te punesimit. Permiresimi i aksesit tek shërbimet shëndetësore dhe lehtësime te tjera do te kete nje efekt pozitiv ne mireqenien sociale.





Reportazh - Duke udhëtuar nëpër Mokër...

# Lart në Trebinjë, ku çelin lulet mes deborës

Nga Skender DEMOLLI

Komuna Trebinjë, në Mokrën e Sipërme, një nga më të mëdhatë në Qarkun e Korçës, dikur ndër më të populluarat, në rrethin e Pogradecit, në vitet e para të tranzicionit të vendit, fshatrat e saj u rruhdhën dalëngadalë nga emigrimi i banorëve të kësaj zone dhe sot në këtë komunë malore, numërohen rreth katër mijë banorë.

Janë 15 fshatra, në një terren malor, ku gjendet 70 % e fondit të pyjeve e kullotave që ka rrethi i Pogradecit, ku të rinjtë, më shumë se prindërit e tyre të kaluar në moshë, e shohin këtë pasuri si garanci për zhvillimin e tyre ekonomik tani e në të ardhmen.

Dritan Çezma, i cili është kthyer këto ditë nga emigracioni në Greqi, me kursimet e tij në vendin fqinj, do të investojë në blegtori, ashtu siç kanë bërë mjaft të tjerë, me fermat e dhive të vendit.

Tani në fshat nuk mungon asgjë dhe sipas kryetarit të komunës Fehim Jasharllari jo vetëm nuk ka tendencë të largimit prej tij, po përkundrazi, mjaft prej banorëve, që dikur ishin larguar në Pogradec, po rikthehen në shtëpitë e braktisura dhe i restaurojnë ato sipas kohës, po mbjellin drufrutorë dhe sytë i kanë edhe tek prodhimet e dyta të pyllit, veçanërisht për bimët medicinale, me të cilat kjo komunë, deri në majën më të lartë të saj në malin e Kozicit, është ndër më të pasurat.

“Trebinja, qendra e saj, jo më shumë se 14 kilometra larg Pogradecit dhe në mos sot, së shpejti prët miratimin e projektit që ka dërguar për miratim në Fondin Shqiptar për Zhvillim, për asfaltimin e saj”, thotë kryekomunari.

Besimi dhe shpresa për të tilla ndryshime, më shumë se tek fjalët e kryetarit të komunës, tek banorët e saj shprehet tek investimet që janë një realitet i prekshëm për të gjithë.

Nuk është fjala vetëm për shtëpitë e reja dhe mobilimin e tyre, por tek mundësitë e mëdha që ofron sot për fshatarin sistemi demokratik, për ta bërë dheun dhe veten e tij të pasur. Po të vesh re edhe peizazhin shqiptar kur udhë-



ton, vilat e reja janë ngritur, deri aty ku ka arritur asfalti. Sepse udha në mendësinë e tij është jo vetëm garanci për zhvillim, por të bën protagonist, në tërë jetën e vendit.

Kjo duket edhe në Mokrën e Poshtme, drejt komunave të Propishtit e Velçanit, me 23 fshatra e mbi 12.000 banorë. “Era qytet bie deri këtu në Golik, ku mbaron edhe asfalti, thotë mësues Hekurani, nga Hondisht, i cili pohon se investime të tilla nga ana e Qeverisë po e nxjerrin fshatin nga izolimi dhe po krijojnë kushte e mundësi që çdo kush të jetojë aty ku dëshiron vetë”.

Punës në fshat sot i janë kthyer

er të gjithë, se përpos plotësimit të nevojave të veta, asnjë nga prodhimet nuk u shkon më kot. Edhe grupimet e mëdha të fermerëve kanë mulluar si ato sytë at e pemëve këto ditë, kur Mokra është e mbuluar ende me borë dhe nesër do të jenë një realitet i zakonshëm, si lulet që priten të çelin. Pak vite më parë, tregon shkriktari Istref Haxhillari, ia lashë shtëpinë tunc në ruajtje në fshatin tim Dunicë, bashkëfshatarit tim Fatmir.

Dunica ka qenë nga fshatrat më të varfër të komunës, si tërë Mokra që megjithë ndryshimet e bëra, ende është prapa në

krahësim me të tjerët. Megjithëse sot, sipas të dhënave të komunës, vetëm 500 familje janë në nevojë. Kjo, sepse disa vepra, si; ujëmbledhësi i Bujazës që ujiste qindra hektarë, nuk doli jashtë përdorimit vetë, thotë kryetari i komunës Fehimi, i cili njëkohësisht është edhe një nga agronomët më të shquar të Pogradecit.

I shkullën dhe i shitën tubacionet për skrap, elementë të pa ndershëm të zonës. Dhe prodhimi i kulturave bujqësore, vajti në fis, te kapaciteti i tyre në gjendje të egër. Dhe pa ujë nuk mund të flitet për mirëqenie. Ja ku buron Shkumbini, në Mokër. Tani lind

nevoja për investime të reja... Po gjërat nuk bëhen me një të rënë të lapsit!

Dhe për kryetarin e tyre, të cilin bashkëfshatarët e tij e kanë votuar si përfaqësues të Lëvizjes Socialiste për Integrim dy herë, thonë se e ka lapsin mjaft të mprehtë dhe të bind për ti bërë gjërat së bashku..

Po më mirë se çdokush, për këtë flet gjendja e komunës. Është ndër komunat e rralla në Qarkun e Korçës, pa borxhe në të tretë. Është ndër komunat që megjithë terrenin e thyer malor, ka sistem ndriçimi rrugor në tetë fshatra të saj njëllor si në qytet dhe në gjashtë mujorin e parë të këtij viti ka planifikuar ta mbyllë atë edhe në Oshtecë e Selcë. Siç ka planifikuar të bëjë rikonstruktionin e shkollës së mesme në Trebinjë, ujësjellësit e fshatrave Kalivaç, Çezmë, Trebinjë-Pevelan, Malinj, Pleshisht, apo lidhjen me sistem rrugor me qendrën e komunës të tetë fshatrave të saj si dhe të asaj Trebinjë- Çezmë – Shën Marenë.

Fermerët të shumtë kanë përfitur e po përfitojnë nga skemat mbështetëse financiare të ministrisë së Bujqësisë për të shtuar pemtorët, blegtorinë e kapacitetet përpunuese të prodhimeve të tyre. Mjaft prej tyre, këto ditë që Qeveria hoqi tatimit mbi mjetet e blera për mekanikën bujqësore, plehrat kimike, farërat, fidanat e materialin racor të bagëtive, në konsulencë me specialistët e bujqësisë që nuk përtojnë, po implementojnë ide të reja për strukturën e prodhimit në fermën e vogël të tyre.

Dhe këto ditë dimri, kur mes borës në Mokër shikon të çelin lulet e para të pranverës e të prishet qetësia e dimrit nga blegërimat e qingjave e kecape të porsalindur, më shumë se lulet e verdha të thanës që ka çelur gropave e përrenjve apo lules-lëvarë si argjend të lajthisë, natyrën e bën më të gjallë peizazhi njerëzor. Peizazhi i ripërtërirë njerëzor i Mokrës, me djem e vajza që pasi e lënë mënjatë internetin, shkojnë në një nga sallat e mëdha në qendër të komunës, ku promovohet vëllimi poetik i Laureta Xhaferrit-bijë Mokre. Se Mokra sot ka edhe shumë shkrimtarë e poetë të rinj.

## Qeverisja vendore me këshilltarë të marrë peng

**T**ë flasësh se kush është parlamenti mendoj dhe është shumë e qartë. Është vendi ku bëhen ligje, vendoset drejtësi, zgjidhen problemet e qytetarëve e atyre që i kanë votuar. Me votën e qytetarëve këshilltarët janë ulur në ato karrige që kanë një mandant 4-vjeçar. Por ndokush e di si zgjidhen ato nga partitë, që është për t'u habitur që ne shqiptarët kemi aq parti sa populli nuk i mban mend. Aq herë sa një person ndodhet në një parti në forumet drejtuese dhe sa herë që ai nuk vete atje ku do të shkojë për një periudhë disa mujore. Formon një parti duke gjetur një emër: e pra këto parti them dhe të vogla po të bëjnë këshilltarë që t'i të jesh në këtë parlament vendor. E në fushatën e 2011 të cilën vura re se shumë këshilltarë u bënë nga këto parti të cilat po t'i mbledhësh s'besoj të kenë antarë. Por votat u morën dhe duke u thënë qytetarëve unë do të ndihmoj po më ndih-

move. Dhe çfarë vura re u bënë ata që dikur kanë qënë në pushtet pothuaj dhe në monizëm, duke ditur se në atë kohë u kanë bërë ndonjë nder. E dy partitë e mëdha i bënë me listë emërore pavarësisht aftësive që mund të kenë, sa të aftë do të jenë ata të mbrojnë interesat e votuesve.

Do mendoja dhe do ishte demokratike që këshilltari të zgjidhet në një lagje me emra të çdo subjekti dhe banorët të votojnë cilin të jetë më i miri. Pra, mendoj se është demokratike dhe duke iu bazuar dhe sipas ligjit të këshilltarit ai duhet t'ju tregojë zgjedhësve çfarë probleme u diskutuan. E ky nuk di kujt t'i japë përgjigje se votat i ka merrë në gjithë qytetin, e kjo më shpie tek një pyetje pa përgjigje: shumë veta marrin asistencë e cila shkon deri në 2500 lekë, po them a mund të jetohej me 2500 lekë? Jo, kur vetëm për drita e ujë shkojnë më shumë se aq, ndoshta edhe dyfishi e trefishi. Di që asistenca është dhe kontroluese. Mjafton të bësh ndarje pavarësisht se ti rri bashkë mund të mar-

rësh asistencë po dhe prindërit e tu kanë një dyqan apo dhe një makinë. Kjo ndodh se ligji i asistencës është sa zbatues e kontrollues: të marri atij që i takon dhe mundësi sa më pak të marrin do marrin më shumë lekë. Por këshilltarët që kanë marrë veten të përgjigjen me një fjalë kaq është fondi sepse ai është i gjithë qytetit dhe 1-2 lagjeve. Dhe kam mendimin që ata duhet të bëjnë takim me zgjedhësit ku të evidentojnë problemet që ata ngrejën, dhe ligji i këshilltarit besoj se kështu është. Në këtë qytet në mandatin e parë një këshilltar kishte ndërtuar një disko u prish se ai nuk u zgjodh më kur duhej prishur me kohë se që një çiban për liqenin. Duke menduar që është demokratike që mbledhja e këshillit bashkiak të jetë e hapur dhe me media (TV) që qytetarët të dëgjojnë çfarë problemesh ngrihen dhe si flasin këta këshilltarë që të shpjegojnë në vend zërin e votuesve apo i asaj paqe që me një mbledhje mujore marrin 8000 lekë.

Lavderim MIMINLLARI



## Në ditëlindjen e librit "Heremit" të Bujar Balliut

Cila është ditëlindja e një libri? Kur autori mbyll gjithçka dhe nis për botim, kur del në treg, apo kur pranohet "zyrtarisht" prej lexuesit? Ndoshta kjo e fundit, më e zhurmshja.



Më 16 shkurt 2013 libri "Heremit" i Bujar Balliut pati aktin e paraqitjes. Autori i emocionuar, bashkëpunëtorët e ngushtë të shqetësuar. Lajmin e parë të mbarësisë e dha dielli në kurrizin e rrudhur të Malit të Thatë. Dita e bukur edhe pse mes i dimrit. Shëtitörja "1 Maji" u gjallërua. Shkrimtarë, poetë, artistë, dashamirës të letërsisë u drejtuan në picerinë "Te babo" zbukuruar enkas për këtë ditë.

Dera filloi të hapej shpesh e më shpesh. Zunë vend të gjithë. Krijuesit pogradecarë patën rastin të takojnë e shkëmbejnë mendime me miq të largët. Bujtën nga Tirana botuesja, Flutura Aça e poeti Ilir Balili, nga Korça Skënder Rusi, Skënder Demolli, Hysen Kobellari, Vladimir Toroveci, Artur Balli, Vehbi Furxhi, Arjan Kallço me tre miq italianë etj., nga Kavaja Durim Çaça, nga Elbasani Fatmir Musai e Lida Lazaj, nga Rrogozhina Xhelal Tosku, nga Gramshi Pozaet Qose, nga Devolli Kosta Nake etj.

Kuratorja Marjana Shkurti, elegante në sjellje, elokueante në fjalë, natyrshëm uron mirëseardhjen:

"Bujari na mblodhi sot me librin "Heremit" që vjen sa i vërtetë aq dhe filozofik, sa i bukur aq dhe i thellë. Faleminderit që jeni me ne shkrimtarë, artistë, të largët e pogradecarë, dashamirës të artit, miq e pjesëtarë të familjes." Pastaj bën një pasqyrë të shkurtër në jetën e krijimtarinë e autorit duke vënë theksin në kredon e tij letrare: "Të shkruash... Intrigë si droga, droga, kumari, zhbirim në hapësirat e shpirtit të së djeshmes e të sotmes. I vetmi shpërblim, lexuesit, të bëjnë të mendosh se shkrimësia nuk është dhe aq marrëzi".

Mikronin në dorën e Marjanës këngëzozon e vërtitet për sallë.

Fjalën e merr botuesja Flutura Aça: "Bujar Balliu e kisha dëgjuar e lexuar, po miq na bëri libri "Heremit". Ai është mjaft i kujdesshëm me fjalën. Zotëron plasticitetin e saj dhe e vendos me mjeshtëri në vendin e duhur. Tregimi është zhanër i vështirë, sepse nuk duhet të japësh thjesht mesazhin, por ta përcjellësh atë me mjetet e letërsisë. Dhe këtë Bujar Balliu e bën me originalitet. Në kohën e mbushur me mediokritete, tregimi i tij sjell nivel të lartë, të dallueshëm, me interes të spikatur artistik".

Studjuesi Bardhi Hyka është konçiz e racional:

"Bujari vjen pas dy librash të tjerë, por ky është më i interesanti. Te "Nëpër shkallë" shikojmë fatin e secilit prej nesh. Aty ndiejmë shkrimtarët modernë Xhojsin e Borge-sin, por edhe Kutelin. Tregimi nuk ka personazh. Peizazhi i flet më shumë nënvetëdijes. Kështu vepron edhe te tregimi "Loti".

Bujari ka parimin më mirë të mos shkruash fare se sa të shkruash keq. "

Poeti elbasanas Fatmir Musai me ton të shtuar e aftësi për të zotëruar auditorin, nxiti ata që marrin sot për herë të parë në dorë librin:

"Kur flasim për librat na vete mendja te parimet estetike. Por unë do t'i le këto mënjatë për të kërkuar prej jush të lexohet "Heremit" me vëmendje artistike, sepse aty përcillet përvojë e gjatë krijuese. Kjo ndodh pasi Bujari kur ka heshtur në krijimtarinë, çuditërisht ka shkruar edhe në heshtje. Ka qenë eremit në shpellën e gjok-sit apo të kokës, shtegtar në grykat e "Fons vitae", student harrakat, gjahtar shpirttrash etj.. Në tregime vjen era Bujar. Ai shkruan për vete, pa pyetur se ç'mendon lexuesi, nuk e vret mendjen për të gjetur shijet e tij. Le të ngrihet lexuesi në nivelin e shkrimtarit."

Poeti Skënder Rusi e ka të vështirë të përballojë emocionet e rastit prandaj fjalën e tij e lexon poeti Artur Balli:

"Përshëndetje Bujar Balliu!

Kjo mesditë është e jotja dhe ti vendose ta ndash me ne, miku i mirë i të gjithëve. Ashtu si një qiri ndez një tjetër e kështu gjenden të ndezur qindra qirinj, ashtu si një zemër ndez një zemër tjetër e kështu gjenden të ndezura qindra zemra,

ashtu dhe shpirti yt ndez një tjetër, e kështu janë ndezur qindra shpirtëra. Dhe kështu ti e ke bërë detyrën tënde fisnike. Sepse është më e rëndësishme të ndezësh një qiri, qoftë edhe të vogël, sesa të mallkosh errësirën- thoshte Konfuci.

Të hysh vonë në "Pallatin e letrave" ku të tjerët kanë zënë vend e nuk lëvizin prej andej, kur, për një çast të del përpara mendimi se je në kohë të gabuar që ke hyrë në letërsi, kur këta të tjerët, vështrojnë me ankth, do të thotë që ti GUXON, që ti po hyn pa trokitur brenda asaj porte dhe që ti o i vonuar, po u thua të tjerëve: JAM EDHE UNË që ju kam munguar dhe dua vendin tim!

Dhe ne prandaj jemi mbledhur, t'i tregojmë vendin Bujar Balliut që po hyn brenda misterit të letërsisë, e cila do ta kryqëzojë atë, siç bën me çdo Krisht të letrave dhe do ta bajë peng për gjithë jetën!

Se letërsia është dashuri, por është më tepër dhimbje. Në letrën që i dërgon El Grekos, Kazanzaqis, mes të tjerave i thotë: "Ti lexues, kushdo qofsh, duhet ta dish se çdo njeri i denjë për t'u quajtur bir njeriu, ngarkon kryqin mbi supe për t'u ngritur në Golgotën e tij".

Ja, cilat do të ishin disa epitete të prozës së shkurtër të Bujar Balliut, që e bëjnë atë të jetë e veçantë në llojin e vet:

1-E thjeshtë gjer në çuditshmëri. 2-E sinqertë gjer në naivitet. 3-Lakonike gjer në veçanësi. 4- Jetësore gjer në besueshmëri. 5- E nxehtë gjer në marrëzi. 6- Metaforike gjer në poezi.

Këto janë dhe fytyra e vërtetë artistike e Bujar Balliut.

Çdo tregim është një copëz e marrë nga jeta e bukur dhe e shëmtuar njëkohësisht. Libri është plot metafora dhe merr frymë përmes një ajri poetik.

Ndonjë verëjtje?

-Ah, po, ka pak liqen.

Miku im!

Ti je në mesditën e moshës dhe librat e tu nuk duhet të mbarojnë këtu, ashtu sikurse asgjë tjetër e jotja nuk duhet të mbarojë këtu, por duhet të vazhdojë, duhet të dëshmojë se ne raca e shkrimtarëve jemi vitalë dhe të çuditshëm, se ne, edhe kur s' kemi qiell atë e krijojmë, edhe kur s' kemi shpresë atë e gjemë, edhe kur s' kemi rrugë atë e ndërtojme.

Vladimir Toroveci nuk ka dëshirë të flasë shumë, por nuk i rrihet pa përshëndetur:

"Bujari më befasoi. E kam zili për librin, për Pogradecin dhe shoqërinë që besoj se ndikon në sendërtimin artistik të krijimtarisë së tij. I uroj suksese."

Istref Haxhillari

Eduart Sulollari dhe unë kemi qenë më pranë "Heremitit" të Bujarit. Që në fillësë të ngjizjes së prozave të tij e derisa ato u formësuan dhe erdhën në pamjen që i janë

dhënë sot lexuesit. Shpesh jemi ngrënë, kemi kundërshtuar njëri-tjetrin për sjelljen e personazheve, mënyrën e finalizimit të ngjarjeve e deri për fjalë dhe fjali të veçanta.

Sidoqoftë roli jonë ka qenë ai i parukjes që përpiqet të krehë dhe rregullojë një vajzë pa i ndryshuar asgjë thelbit të saj. Të gjitha prozat e Bujarit mbajnë vulën e shijeve të tij letrare, koncepteve estetike dhe mënyrën si ai e percepton realitetin. Jo rrallë mes nesh ka funksionuar parimi i lashtë "Ti thuaj mendimin tënd, unë tund kokën time".

Në variantin e parë të parathënies sime për këtë libër kam shkruar një pasazh që Bujari ma hoqi pa marrë miratimin tim. Po të funksiononte në Shqipëri ligji për mbrojtjen e të drejtës së autorit unë do ta hidhja në gjyq Bujarin dhe do t'i merrja ka para. Sipas Pojanakut do të detyrohej të më paguante afërsisht një pagë mujore. Meqë ky ligj nuk gjen zbatim unë gjeta mënyrën e zakonshme që përdoret në këto raste. U zemërova ca kohë pastaj u pajtuam përsëri. Po nuk ia harrova. Prita rastin të hakmerrem. Dhe ky rast erdhi sot në këtë auditor të nderuar. Dëmi mund të jetë ca i madh se ka të ngjarë që pas kësaj të nisë një proces gjyqësor divorci.

Në mesin e viteve 70, kur Bujari ishte student në Universitetin e Tiranës, u gjend në një mjedis të rinjsh entuziashtë, me ëndrra të mëdha. Mes tyre Valter File, Mimozza Erebara etj që më vonë dolën mbi ujë dhe u bënë shkrimtarë dhe poetë të njohur. Ai u përfshi në këtë lëvizje inteligjente dhe botoi në gazetën "Drita" një cikël me poezi me pseudonimin B.B. Ato u pritën me entuziazëm nga miqtë e tij dhe më gjerë. Po stononin me atmosferën revolucionare të atyre viteve. Shkodrania e bukur kishte sy të shkruar, romantikë po nuk dinte të merrte vijën e shënimit dhe në qitje dilte e fundit. Kjo nuk kishte rëndësi për studentin e dashuruar, po nuk ishte kështu për ca të tjerë. Ndonjë fjalë e hedhur kuturu e trembi studentin dhe ai u tërhoq nga një rrugë më rrezique.

Ja këto kisha shkruar në parathënie e këtij libri shkurt me dy tre rreshta. Nuk e mora vesh nëse i hoqi për modesti apo nga frika e gruas që nuk e di edhe sot e kësaj dite.

Imë te një pyetje që ngacmon cilindo në këto raste promovimesh. Përse duhen lexuar tregimet e Bujar Balliut? Sot shkruhet aq shumë sa të ikën dëshira të lexosh. Unë them se prozat e këtij libri duhen lexuar për të njëjtën arsye që dëgjojmë një këngë apo vizitë një ekspozitë Picture.

Për ndjesinë estetike që të krijojnë këto tregime. Ato rrjedhin natyrshëm, pa sforcime, me fjalë të kursyera sa ndonjëherë du-

het t'u rikthehesh për të lidhur fillin. Prizat ngjanë me mjalitin natyral që për ta shijuar duhet të ngitesh në majën e pishës së lartë. Ato nuk janë mjalte në frigorifer dhe ky është një dimension i mrekullueshëm i artit. Ashtu si një pikturë e arritur të fut në mendime për të gjetur nënshënien e pikturit, çka e dallon atë nga fotografia e thjeshtë. Fjala e zgjedhur kumbon si melodi me një fill harmonik të këndshëm. Tregimi "Nëpër shkallë" lexohet për dhjetë minuta dhe të mbetet në mendje për atë detaj të hollë plot elegancë. "Fons vitae" sjell me pak fjalë një epokë të madhe historike mbushur me erudicion mahnitës.

Ashtu si e kam shkruar në parathënie prozat e Bujarit janë copëza të mbetur në kujtesën e autorit prej një kohe të gjatë siç na ndodh të gjithëve. Ai i end me pëlhurën e fantazisë dhe i sjell në një formë elegante, të asimilueshme. Personazhet janë gjithfarësh, udhëtojnë nëpër kohë dhe ne i shikojmë si të jenë të gjallë përpara nesh sot e kësaj dite. Leximi i një libri të tillë nuk të lodh, por të kënaq.

Prandaj ia vlen ta lexosh.

Shkrimtari Thanasi Jorgji dërgon përshëndetje nga Gjermania: I dashur Bujar!

Lexova me vëmendje dhe ME SHUMË KËNAQËSI "Heremitin" tënd dhe nuk më pritët të të përgëzoj. Ke shkruar një libër të cilin rrallë mund t'ia gesh shokët në letërsinë shqipe e ndoshta më gjerë!

Proza jote është moderne, e ngjeshur, vertikale, me zhbirime psikologjike. Prozë me densitet të lartë. Sipas shijes sime letrare, ti je diku midis Buzatit ("Pak para shembjes" etj.) dhe Kortasarit ("Nëpër shkallë" etj.) Në të gjithë vëllimin t'i e paraqet veten jo vetëm prozator të talentuar, por edhe shkrimtar me kulturë të gjerë, shumë të lexuar dhe me njohuri të thella historike. Kjo bie në sy sidomos tek novela "Fons vitae", e cila më ka lënë përsh-typje të veçantë. Në teknikën letrare të të shkruarit, në prozën tënde vihet re dialogu lakonik, në më të shumtën i qëlluar, por ka edhe raste kur lakonizmi, shkurtësia e shprehjes së mendimeve të personazheve sikur kthehet në qëllim në vetvete. Ajo që është e padyshimtë dhe e sigurt është fakti se ti je prozator i nivelit të lartë. Proza jote është e rrjedhshme, e shkruar me dorë të sigurt aq sa duke e lexuar vëllimin të bëhet të besosh se ai nuk është libri yt i dytë, por i dhjetë! Kjo ndoshta ngaqë ke pasur redaktor shumë të mirë. Nëse jo, atëhere merita të takon e gjitha ty! Kritiku Kosta Nake e vuri theksin në stilin e të treguarit:

"Është vlerë për çdo krijues nëse ia del të shpërfaqë stilin e vet në një libër të vetëm. Ky është përfundimi që mori trajtë kur arrita në faqen e fundit të vëllimit me tregime "Heremit" të Bujar Balliut. Është nga të paktët libra që më kanë bërë t'i rillejoj fill pasi kam kthyer kapakun e fundit. Dhe kjo është një rrjedhojë e stilit të këtij tregimtari. Nuk është një karamelë që mjafton ta futësh në gojë dhe tretet vetë, por është një arrë që duhet thyer, madje mund të jetë nga ato që i quajmë gunga dhe duan edhe një thikë për t'i nxjerrë thelpinjtë e thyer që struken nëpër zgafele. Nuk është një lundrim në një det të qetë nën një diell apo hënë plot dritë, por një hapësirë me kreshta shkëmbinjsh që të shfaqen aty-këtu, me shkëmbinj të nënujshëm dhe zezona të frikshme që duhet t'i vëzhgosh me kujdes, prandaj nuk mund t'u japësh fort lopatave drejt brigjeve të gjelbër. Tregimtari operon me fjali të shkurtra gjë që i jep temp edhe rrëfimit edhe veprimi. Peizazhi shpesh kthehet në një poezi. Rrëfimi i autorit bëhet si nëpër një tis mjegullor që edhe të shton kurrsh-tjen, edhe të mpreh vëmendjen. Ka një mbikëqyrje të shtuar të autorit ndaj hënës. Ky rrëfim, së bashku me zgjedhjen e subjekteve dhe karaktereve përfiton një mjedis të ngjashëm me atë të romantizmit europian. Nusja e tregimit "Nëpër shkallë", Dea e tregimit "Pëllëmbët", Bora e tregimit "Pështjellimi", Nurseli te tregimi "Pak para





shembjes", Jeta e tregimit "Jeta në dy net" janë personazhe jo të zakonshëm. Udhëtimi i Jetës (Jeta në dy net) në kërkim të qumshutit të humbur të gjirit drejt zgërbonjë në Ramje, kalimi i Përroit të Thellë në tregimin "Udhë e shtëpisë", silueta e pakapshme e kurbatës tek tregimi "Peng në gjë të hënës" janë mishërime tipike të këtij romantizmi.

Dialogjet nuk janë vendosje natyrale të replikave, por prerje të zgjedhura në funksion të mesazheve që do të përcillen. Ndërprerja e rrëfimit në udhëkryq është një tjetër veçori e stilit të Bujar Balliut. E ndeshim te tregimet "Ku...", "Qyteti brenda tij", "Fons vitae", "Udhë e shtëpisë", etj.

Puna e kujdesshme me fjalën, madje futja e terminologjisë për fushën përkatëse të shkencës që ndërthet tregimi, është një tipar tjetër i stilit të autorit, i vetëdijshëm se po i drejtohet një elite lexuesish dhe jo më një lexuesi të zakonshëm që sa vjen e bëhet më i largët dhe i turbullt në horizontin e letërsisë artistike."

Në atmosferën brenda librit pjesëmarrësit e takimit i futi recitimi i tregimit "Loti" nga tre gjimnaziste; Frigera Çoçka, Fatma Çekiçi, Zhuljeta Kaftirani.

Dhe vazhdojnë diskutimet...

Andi Kosta: "Heremit" ka gjuhë artistike të përpunuar me synime të qarta. Autori di të luajë me harmoninë e disharmoninë e kohëve foljore, me ndërthurjen e përshkrimit fizik në funksion në shpirtërores. Vepra e Bujar Balliut është nonkonformiste."

Durim Çaçaj: "Letërsia e vërtetë depërton përmes prurjeve kuptimore, por edhe në pasurinë gjuhësore që shpërfaqet origjinale, pa rënë nën peshën e të mëdhenjve. Sentencat kuptimore mbajnë peshë përfytyrimin e lexuesit, figuracioni i natyrishtësiguron përjetim në situata larg racinales."

Piktori Anastas Kostandini (Taso) ka një mllëf të fshehur që e shpërfaq me inatën e artistit. Nënteksti flet më shumë se e dukshmja: "Disa mendojnë se artistët piktorë janë të dënur të flasin vetëm me tela-

jot e tyre. Letërsia nga Bujar Balliu dhe dy miqtë e tij Istref Haxhillari e Eduart Sulollari vjen te unë e përkthyer në vlera të vërteta. "Nëpër shkallë" e "Fons vitae" flasin me simbolizmin ballkanik. "Heremit" ka ardhur me një gjuhë të veçantë". Gjuha është kaq e dendur dhe primare sa të gjitha kuptimet bien, ka rëndësi vetëm fjala. Ajo fjalë që për mua shpesh merr vlera piktorike."

Besnik Xhelo: "Fakti që na mblodhi kaq njerëz dashamirës të letërsisë, tregon se kemi të bëjmë me një personalitet. Përgëzot autorin për freskinë tematike dhe përguximin me të cilin hyn në fushën e letrave.

Eduart Sulollari përshëndeti me poezinë "Prelud", Skënder Rusi me poezinë "Puthja e gabuar".

Fjalën e shkrimtarit Valter File e përcollti poetja Loreta Xhaferi.

Ne kemi harruar të lexojmë tregime dhe kjo ka sjellë mungesën e njohjes së copës së vogël që jep shijën e veçantë të së bukurës, parë në atomin dhe elementin e vet. Këtë kënaqësi, si një zbulim i papritur, mund ta marrësh në masa të vogla dhe të voganta nga proza e spikatur e shkrimtarit pogradecar, Bujar Balliut.

Në tregimin e parë të vëllimit "Nëpër shkallë", ndjeva një nuancë të fshehtë dhe të mistershme të botës së trazuar të njeriut që kalon në monolog me vetveten dhe që të kujtonte së largmi Borhesin dhe të tjerë shkrimtarë latinë me shkollën e realizmit magjik. Pra ndeshesh me magjinë e një realiteti semplik dhe këtë ndjesi vazhdon ta kesh deri në faqen e fundit të librit. Përfunduesisht është e vështirë të dallojë në ato që shpalosen faqe pas faqeje i përkasin realitetit të mirëfilltë, apo janë copëza ëndërrash të përziera me mjegullimin e përgjumjes. Pikërisht këtu qëndron edhe orgjinaliteti dhe vlera e sjellë e librit me tregime "Heremit".

Mjafton t'i referohemi tregimit "Pësh-tjellim". Është një copë jete. Të duket si një vizatim natyralist i Tiranës, qytetit të rrëmujshëm, por që në fakt rrëmujua nuk

kërkohej në rrugët e zhurmsme, por në kokën e personazhit. Dhe fillon të marrë vlera, jo më ajo që është racionale, ajo që na kërkon përditë arsyeja e ftohtë, që jemi mësuar ta prekim, ta dëgjojmë, ta shohim e ta shijojmë, por del në pah një shtresim irracional, i cili pluskon nga thellësia për të dalë në sipërfaqe dhe për t'u shfaqur i copëzuar. Ajo që është fshehur brenda nesh, njerëzve të zakonshëm, bëhet e kapshme. Bujari e pranon në tregimet e veta irracionalen si një pjesë të arsyeshme të jetës. Në këtë tufë tregimesh ndeshesh pikërisht me personazhe të dyzuar, në vetë të parë ose të tretë, femra ose meshkuj, që duket sikur jetojnë dy jetë. Jetën sipërfaqësore që kërkon morali i kohës dhe jetën e brendshme që buron nga thelbi i shpirtit të njeriut. Kjo lloj letërsie është fruti i jetës së dyzuar dhe realiteteve të përziera që detyrohet të jetojë gjithkush prej nesh në këtë kohë të trazuar. Nusja në tregimin "Nëpër shkallë" është gjithkush, unë, ti, ai tjetri që pa vetëdije përjeton dhe ndien atë që ia kërkon shpirti dhe ia mohon arsyeja. Autori luan mjeshhtërisht me motivin e kakofonisë. Pothuajse të gjitha tregimet duhet sikur kanë brenda një rrëmujë, një tollovi, që herë vjen nga jashtë, nga të tjerët që e kthejnë personazhin në objekt, por njëkohësisht po kjo kakofoni, këta zëra të brendshëm, këta këshilltarë zëllët, burojnë edhe nga vetë ndërgjegjia e personazheve. Tregimet janë të zhurmsme, dhe kjo zhurmë nuk ndjehet në sipërfaqe, por në thellësinë e tyre. Është një zhurmë dhe rrëmujë që buçet, shungullon, por nuk duket. Letërsia e Bujar Balliut ka vullën e vet origjinale. Zinxhiri i tregimeve, të shkurtër por të larmishëm, ndërton një botë të tërë dhe të krijon përshtypjen e mirëfilltë të prozës së gjatë dhe të kompletuar. Pas leximit të "Fons vitae", "Vdekja hutohet", "Qyteti brenda tij" etj. ndihesh sikur ke mbyllur romane. Përdorimi i kontraveerse, si në tregimet "Pësh-tjellimi", "Sakrilegj" apo "Vdekja hutohet" merr përmasat e elipseve kinematografike që mbartin në vetvete

rrëmujën e zakonshme të turmës, brenda mendimit të përgjithshëm mbizotërues të asaj që ne përrjetojmë, ndiejmë dhe shikojmë në këtë kohë, por edhe në atë që ka qënë dikur dhe atë që do të vijë pas kësaj. Pra bëhet fjalë për një letërsi të një lloji të ri, të paktën përsa i përket letërsisë sonë të shkruar në prozën e shkurtër. Bujari Balliu krijon letërsi vërtet të mirë dhe interesante në orgjinalitetin e vet." Marjana Shkurti la mënjane mikrofonin dhe recitoi poezinë për verën.

Pastaj e përcollti mikrofonin te pjesëmarrësit. Ilir Balili

"Krijimtaria e Bujarit na thotë se korifejtë e letërsisë vazhdojnë jetën e tyre krijuese në Pogradec. Ai të fut në mendime filozofike e artistike me tregimin e tij."

Hysen Kobellari: Heroi i ditës është Bujari. Unë e përshëndes dhe në emër të gazetës së pavarur "Korça" dhe drejtorit të saj Vehbi Furrxhiu.

Para disa kohësh dikush më pyeti:

-Kush ju çertifikon ju si shkrimtarë?

-Papa,-iu përgjigja. Ai tundi kokën i çuditur e u largua. Tani së fundi mora vesh se Buari ka bërë kërkesë, po siç e dini Papa dha dorëheqjen, prandaj unë propozoj;

"Bujar Balliu nga kjo ditë shpallet shkrimtar cilësor!"

E miratojmë?"

Propozimi u shoqërua me duartrokitje dhe Hysen Kobellari u ul i qetë pranë gotës së verës.

Ylli Çela: "E kam lexuar librin me kënaqësi të veçantë. Bujari ka marrë një grusht miell në magjen e madhe të jetës dhe u mendua: ta bëjë kulaç, s'i del; ta bëjë lakror, punë grash; e bëri ballokume e na kënaqi.

Unë do të bëja thirrje që pushtetarët të bëjnë jo vetëm festa elektorale e festa vere, por dhe konkurse në ndihmë e aktivitete të letërsisë e artit."

Ilir Mani kryetari i komunës Velçan flet me emocion të veçantë. Nga qindra ish nxënës të autorit, vetëm ai dhe katër gjimnazistet që recituan janë në sallë:

"Unë ishinxënësi yt nuk të ndahem. Kam nevojë, por jo vetëm unë, për fjalën tënde, për vështrimin tënd, për librat e tu. Të uroj.

Në fund e mori fjalën Bujar Balliu. Ndihet i qetë. Me zë të shtruar e vështrim të ëmbël mbulon gjithë pjesëmarrësit:

"Shmangia nga kënaqësitë e vogla të jetës së përditshme, kur pranë kompjuterit ngrihen muret ndarëse me botën, mori shpërblimin. Miqtë që kam unë sot, zor se i ka njeri. Ka ardhur shkrimtarja që ka pushtuar vitrinat e librarive e ekranet e televizioneve, Flutura Aça, poeti i ëmbël e i papërsëritshëm Skënder Rusi, rebeli në jetë e në letërsi Xhelal Tosku, shkrimtari Pozaet Qose, miqtë e mij të vjetër, krijuesit Fatmir Musai e Durim Çaçaj etj. Nuk po për mend me emra as pogradecarët as korçarët, se dua ta ndiejnë veten zot sh-tëpie. Ju më keni mbushur mendjen se të shkruash nuk qenka dhe aq marrëzi.

Ua shpërblefsha në të tilla rastete uroj më ne nga Mokra."

Pas fjalës së autorit pjesëmarrësit vazhduan bisedat pranë gotave të verës. Në fytyrën e Mentorit, vëllait të autorit, duken shenjat e çlirimit, dhe ai ndihej në ankth. Alba, studentja e mjekësisë, për herë të parë luajti rolin e kamerieres. Donte që në pritjen e të atit të mos mungonte asgjë. Edhe Landi, Algerti, Miri e Ilva u ulën në tavolinë dhe porositën t'u shërbehej. Shërbimi i tyre për njeriun e familjes kishte përfunduar....

Vetëm në dy tavolina biseda ndizej e ndizej...

Vangjo Gusho, Fatmir Musaj, Durim Çaçaj e Bujar Balliu kujtonin vitet në universitet....

Istref Haxhillari, Skënder Rusi, Eduart Sulollari, Xhelal Tosku, Lida Lazaj, Artur Balli e Loreta Xhaferi përplasnin gotat e verës, poezitë, replikat...





PROFIL

# "Siç thoshte Gjergji..."

Nga Istref HAXHILLARI

Në historinë e përndritur të kulturës po gradecare me shpresëzim të gjerë në gjerdanin kombëtar, doktor Gjergj Pekmezi, figurë zulummadhe e kohës kur jetoi dhe punoi, zë vend qendror tejet të nderuar. Përkushtimi i tij në shërbim të çështjes shqiptare është i shumanshme, me vlera përfaqësuese.

Por, si një çudi e pa kuptuar, vepra e tij madhore lëkundet mes njohjes dhe mosnjohjes, vlerësimit të plotë dhe mosvlerësimit të ndihmesës së pazakontë. Edhe sot e kësaj dite mungon një përmbledhje e plotë e shkrimsisë së tij ku ai shpaloset gjuhëtar, mësues, studiues, atdhetar, diplomat, një ndër shqiptarët më të kulturuar të kohës së tij. Cilido që ndërmer këte nismë, do të nderojë brezin e sotëm përmes një botimi me vlerë të vërtetë në lumin pa cak të librave që mbushin sot letrat shqipe. Përkundër kësaj dëshire të pamundur do të përpiqem të hedh dritë në një përmasë interesante disi të shpërfillur të Pekmezit:

"Mësues i gjuhës shqipe në Mokër e posaçërisht në Llëngë".

Lindur më 1872, pasi mbaroi arsimin fillor e pastaj tre vite të mesme, me dëshirë të madhe për të mësuar, por në pamundësi për të vajtur në Europë ku mund të realizonte ëndrrën e tij, ndërpreu përkohësisht mësimit për të siguruar të ardhurat e nevojshme.

Ishte viti 1887, kur merr rrugën e gjatë e të vështirë për në Llëngë të Mokrës si mësues i të parës shkollë shqipe të këtij fshati. Adoleshenti pogradecar, i etur për të mësuar, rritur në një mjedis qytetar të kulturuar, inteligjent prej natyre iu përkushtua me tërë energjinë këtij shërbimi të madh. Vetëm pak muaj pas çeljes së të parës shkollë shqipe në Korçë që djaloshi e përjetoi me nderim të madh ai do të sillte në Llëngën e largët librat e para shqipe me alfabetin e Sami Frashërit.

Por sa i çuditur mbeti kur aty, në mes të maleve, pikasi abetare shqip future tinës nga patriotët llëngarë shumë kohë para tij? Gjeti në atë vend me hire natyrore mbresëlënëse njerëz të mençur, të dashur e të dhembshur që iu bënë prindër e shkuar prindërve.

A ishte e rastit e papritura e këndshme në atë mëngë të largët të maleve të Mokrës? Natyrisht jo.

Banorët patën çelur vite më parë një shkollë greke ku mësohej edhe vllaçë nga një prift vendali. Mërgimtarët sollën nga vendet ku punonin libra shqip, po asnjëri nuk dinte mjaftueshëm të lëçiste në këtë gjuhë, deri atëherë e panjohur.

Ardhja e Gjergjit i përngjiste shiut në një thatësirë tejzgjatur. Mjedis i pjellor i etur për të mësuar gjuhën e tyre, shpirti patriotik i llëngarëve dhe mikpritja mokrare i dhanë mundësi djaloshit nga qyteti të shpalosë, duke mësuar edhe vetë përmes punës, aftësitë mësimsdhënëse. Në mungesë të programeve të mirëfillta, (



Shoqënisë "Dija" që u krijue me 27 dhjetor të vitit 1904 në Vjenë nga Gjergj Pekmezi e Hilë Mosi

ato kohë mësimi i gjuhës sonë ishte i ndaluar nga administrata turke ) krijon vetë një sistem, ku vendin e parë e zinte nxënija e shkrimit dhe këndimit shqip, pastaj aritmetika ku përdorte goglat e dushkut për të mësuar veprimet me numra, historia e Shqipërisë dhe botës, gjeografia etj. Nxënësit e tij ishin gjithfarësh, nga mosha e njomë tek burrat e pjekur dhe gratë duarlyer nga brumi i bukës, ardhur me nxitim të dëgjorin magjinë e gjuhës shqipe shpalosur nga ky çunak që s'ka mbushur aq syrin në pamje. Zbriste në Pogradec rrallë, të çmallej me njerëzit e tij, po sidomos të mbledhte libra e fletore për nxënësit që e prisnin me padurim të kthehej mësuesin e këndshëm.

Në Llëngë mësimi i shqipes lehtësohej edhe se aty nuk kishte

duaxhinj e përkrahës të turkut si në fshatra të tjerë mokrare, veçan ato më këtë anë lumit ku puna vështirësohej nga përndjekjet e tyre të skajshme. Më të rrallë, kur ndonjë nga paria myslimane e Mokrës vinte në Llëngë, nxënësit shpërndaheshin dhe djaloshi qytetar kthehej në nip apo kushëri tek pihonët, kokoneshët, zho-brot.

Përfund shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në kapërcyell të atij të njëzetë, fshati nuk ishte në pamjen e tij më të mirë, po i mpakur e tkurrur për shkak të shpërnguljeve të shumta nëpër vende të tjera sidomos përqark Tiranës. Në viset ku shkuan ruajtën zakonet, fenë dhe kulturën që e përcollën tek të tjerët. Janë pikërisht llëngarët e shpërngulur në Tiranë që ndërtonan kishën e Shën - Prokopit, ndër

më të spikaturat, me vlera të mëdha për ruajtjen e besimit ortodoks dhe kulturës arbërore. Taksat pa fund për t'i detyruar banorët të përqafonin fenë islame nxitën largimet masive nga vendi i tyre i begatë.

Për shkak të numrit të kufizuar të nxënësve në Llëngë, Gjergji e shtoi punën e tij si mësues shëtitës nëpër fshatra të tjerë të Mokrës së Sipërme për të rritur pagesën, por sidomos të jepte ndihmesë në përhapien më të gjerë të shqipes ndër djemtë mokrare.

Në mësimit harrohej pas tingëllimës së mrekullueshme të gjuhës sonë, po edhe historisë së Skënderbeut, maleve e fushave të Shqipërisë, legendave dhe bëmave të të parëve tanë nëpër rrjedhat e historisë. Fjalët e tij mbeteshin në mendjen e atyre që e dëgjorin dhe

kapërcenin kohën nga njëri brez tek tjetri.

Në vitin 1978, kur isha në Llëngë për punën time si inspektor i arsimit, kam takuar një burrë të moshuar nga fisi i Tonave që më çuditi kur tha se në Mokër ka qenë vetë Skënderbeu kur nisi të bëjë Arbërinë.

- Nga e ke dëgjuar këtë? - e pyeta.

- Ia ka thënë tim ati Gjergji, - ma ktheu, po nuk dinte të thoshte më shumë se për cilin bëhej fjalë. Në mjegullinën e kohës shkëlqente pa pushuar si një xehavhir emri i mësuesit të ditur përmbi të tjerë që erdhën më këtej.

Edhe më vonë kam dëgjuar fshatarë nga Dunica, vendlindja ime, që thoshin kur përmendnin ndonjë gjë të mençur, po harruar:

"Kështu ka thënë Gjergji".

I pavëmendshëm, atëherë nuk u vura rëndësi këtyre fjalëve dhe as e dija kush ishte Gjergji që e përmendnin mokrarët e moshuar, deri vonë kur mësova se jehonte kështu nëpër kohë Pekmezi i paharruar, ngulitur thellë në kujtesën e njerëzve.

Përmbi Llëngë, shpella e famshme e Nikës, limeri i përhershëm i komitëve të Shahin Matrakut dhe Tun Kokoneshit sa herë i përndiqte i huaji, u bë një nga klasat e shumta të mësimit për djaloshin pogradecar. U fliste burrave që kishin lënë shtëpi e katandi ndjekur kush nga hasmi i huaj e kush nga ai vendali për Shqipërinë, Skënderbeun, nevojën e bashkimit për të luftuar turkun e grekun që kërkonin copëtimin e vendit. Komiteti i thëthinin fjalët e djaloshit të mençur dhe mbusheshin me shpresa të mëdha. Gjergji u bë mësues e mik i ngushtë i burrave që e deshën si askush tjetër rioshin gojë ëmbël.

Llënga pastaj Mokra e tërë u bënë edhe shkolla e parë ku zë fill gjuhëtari, historiani, atdhetari dhe mendimtari i ardhshëm. Aty mbledhi gjuhën e virgjër të vendësve, zakonet e tyre të mira e të liga, virtytet dhe veset, përkushtimin për fenë dhe kulturën e lashtë, ritet në gëzime e hidhërime. Si një makinë e kurdisur për punë natë e ditë, regjistroi gjithçka me etje dijetari dhe shpirt të qëruar si cipë qepe. Kështu Mokra dhe Gjergji i ri, në mënyrë të ndërsjellë për dy vite rresht i dhanë njëri - tjetrit gjithë ç'mundën e ç'dinin, po më shumë se çdo gjë shpirtin e kulluar e të hijshëm si vetë trojet e begata të Mokrës dhe si vetë shpirtin e magjishëm të dijetarit të ardhshëm.

Më tej, mësuesi u largua, ngjiti me shpejtësi shkallët e dijes dhe u bë burri që i shërbeu si rrallë tjetër vendit të tij. Në Mokër nuk dinin gjë për këto se njerëzia, zënë me punët e përditshme të mundimshme sa më s'ka nuk kishin shumë kohë, po brez pas brezi u kujtua ai djal i mençur që pat qenë njëherë e një kohë në këto anë. Fjalët e tij melhem për plagë nuk u harruan kurrë. Në kuvende burrash të menduar për hallet e vendit, nëpër historinë e trazuar dëgjohesh shpesh të përmendjet:

"Siç thoshte Gjergji..."

Pogradec 2 mars 2013

## LLËNGA DHE BASHKËSIA ORTODOKSE E TIRANËS

Me prishjen e Voskopojes më 2 shtator 1769, zhvillim të mirë e të dukshëm dhe ishte bërë një qendër ekonomiko-kulturore e zhvilluar, u prish Llënga, Niça, Grabova, Shipcka e të tjera me një zhvillim ekonomik e kulturor gjithashtu të dukshëm.

Më 1767 dioqeza e Durrsit u shpall përsëri mitropoli më vete titullin "mitropolia e Durrsit dhe e Gorë-Mokrës, duke pasur nën vartësi ortodoksit e rrethinave Durrës (ku përfshihej edhe Tirana), Elbasani, Kavaja dhe Pogradeci. Llënga në shekullin e 18-të ishte bërë qendër e madhe e një zejtarie të shumëllojshme, të zhvilluar e organizuar mirë në disa esnafe. Sipas një mbishkrimi që ndodhet mbi hyrjen e kishës së manastirit të Shën Marenës, në Llëngë vepronin disa esnafe, si ai i ustallarëve, i rrobaqepsave, i kasapëve e te tjera. (Zija e Shkodrës, vepra e cituar faqe 285)

Ardhja e këtyre banorëve të rinj me prejardhje nga Llënga, Grabova, Niça, Voskopoja e të tjera e ndryshoi karakterin e Bashkësisë ortodokse të Tiranës. Kjo Bashkësi u vendos brenda në qytetin, në afërsi të pazarit, zejtarët e saj nisën të sistemoheshin me dyqane dhe organizohen në esnafe. Në vitin 1841 nis përshkollën dhe arsimimi i Bashkësisë ortodokse të Tiranës një fazë e re dhe u hap shkolla e parë e rregullt. Ishte një shkollë 4 vjeçare, në vitet 1847-1848 mësues ka qenë Grigor Perliçev, nga Ohri dhe në vitin 1869 Anastas Dhima nga Pogradeci. Në vitin 1890 u hap shkolla e vajzave, dhe në vitin 1897 shkolla qytetëse ngrihet në shkollën 7 vjeçare. Në shkollën e vajzave ka qenë mësues Polikseni Dhima nga Pogradeci, me të motrën Evaniithi. (Alfabeti i gjuhës shqipe dhe kongresi i Manastirit, Tiranë, 1973).

Në bashkësinë ortodokse të Tiranës flitej vllahisht-

ja dhe shqipja, ndërsa gjuha greke ka qenë gjuha e shkollave, e kishës dhe e korespondencës tregëtare. Gjuha shqipe flitej, se një pjesë e popullsisë së Bashkësisë që kishin ardhur nga qendra banimi me popullsi shqiptaro-vllaha, siç qenë Voskopoja, Llënga e tjera, ku ngriheshin dhe fliteshin të dy gjuhët. Familja patriarkale ishte baza e Bashkësisë Ortodokse e Tiranës. Bashkësia ortodokse e Tiranës, pas sistemimit të saj brenda në qytetin, u muar me një herë me problemin e ndërtimit të Kishës. Kisha iu kushtua dëshmorit të madh të krishterimit, Shën Prokopit, i cili njëkohësisht u shpall mbrojtësi i Bashkësisë dhe krenatohej për çdo vit më 8 korrik. Kisha e Shën Prokopit, në këtë gjendje qëndroi deri në vitin 1938, ku në bazë të planit rregullues të Turanës së re, ky monument historik u shpronësua për 8 mijë franga ari dhe u prish. (Dhimitër Bedulli, "Kisha dhe klturë" Tiranë, 2006 faqe 186). Kisha e re e Shën Prokopit u ndërtaua tek kodra e Pashës, dhe u inaugurua më 20 maj 1945. Bashkësia ortodokse e Tiranës ka pasur regjistrat e saj themeltarë të lindjeve, martesave dhe te vdekjeve, sidomos për periudhën që ishte vendosur në qytet. Në vitin 1904 sipas të dhënave në qytetin e Tiranës kishte 724 ortodoksë, shifër që është përafërsisht baras me 140 familje. Në regjistrimin e vitit 1923 ka pasur 150-160 familje dhe arriti deri në 165 familje. Me caktimin e Tiranës në janar 1920, si kryeqytet nga Kongrsi i Lushnjës, u përqendrua administrata, u unifikua arsimi, u arrit bashkimi i popullit tonë. Në këto kushte Bashkësia ortodokse e Tiranës nuk mund të ruante më karakterin e saj fillestar. Ajo dalë nga dalë u shkri në gjirin e popullsisë tjetër të kryeqytetit dhe së bashku morën pjesë në të gjitha veprimtaritë, shoqërore, administrative dhe politike të vendit.

Zenun FERO



# Zako Spirollari, bir i Pleshishtit dhe i Mokrës

Nga Dhimitër Gegprifti

Tashmë duket se ka marë rrugë të mbarë dhe është kristalizuar puna e gazetës sonë me shkrimet e saj kush-tuar kësaj treve me historinë shekullore, me bëmat e trimave popullorë, por edhe me bijt e bijat, që kanë dhënë jetën, kanë derdhur djersën në të mirë të kësaj toke, në të mirë të këtij vendi, që quhet Shqipëri.

Kështu kemi përjetësuar historinë, heronjt, luftëtarët, njerëzit e sakrificave sublimë, por edhe të thjeshtë me historinë e tyre të së shkuarës dhe të së ardhmes. As më shumë dhe as më pak po i ngremë Monumentin e Pavdeksisë Mokrës sonë.

## Pleshishti pjesë e historisë së Mokrës

Nëse ndonjëherë do të na duhej të bënim një bilanc rreth pasqyrimit të historisë mokrre në faqet e medias së shkruar, pa dyshim, që Pleshishti me historinë e tij ka qenë shumë pak i pranishëm. Kjo, jo se i mungon historia, jo se i mungojnë vlerat dhe kontributet në historinë kombëtare, të cilat i ka jo të pakta, nuk i mungojnë njerëzit e penës. Por me sa duket ato janë në proces dhe ky është fillimi i një nisme të tillë.

Fshati Pleshishtë në zonën e Mokrës së Sipërme është i formuar nga dy lagje: Lart dhe Poshtë (Kërkovë). Nga pikëpamja gjeografike ai kufizohet me dy Çezmat: e Madhe dhe e Vogël, me fshatrat Trebinjë, Çervenakë, Mëmlishtë, Hoshteçë, Zëmçë dhe Selcë Sipërme. Edhe ky fshat ka gojëdhënat për historitë e lashtësisë, në të cilat bëhet fjalë për shpërngulje masive të popullsisë, e njëjtë si ajo, që qarkullon për Vemiranin e Pevelanit. Edhe banorët e Çor-



dolit (makrotoponim në këtë fshat, që mendohet të jetë një sllavizëm: (aglutinim) përngjitje e formuar nga çorni=e zezë dhe dolina= luginë, pra Luginë e Zezë) janë larguar për çështje hasmërie apo konflikte me përfaqësues të oborrit mbretor. Sipas gojëdhënës, Leko Spirollari dhe Naum Naqe ishin punëtorë në Rumani dhe nga andej mobilizohen ushtarë në një zonë të Rusisë në Luftën e Parë Botërore. Atje gjejnë fise nga ky fshat, që banonin atje. Xha Lekua gjatë bisedës me Ilien, njëri nga banorët e atjeshëm e pyet shqip: -Nga cili vilajet jini juve? -Në jemi nga Shqipëria, nga kaza Starova, nga fshati Pleshishtë -iu përgjigjen. Plakut iu mbushën sytë me lotë dhe ashtu vazhdoi: -Si, more nga Mokra e Çordolit

qenki ju? I përqafton dhe u thotë: -Edhe unë prej atij vatani jam! Kështu filloi t'u tregonte historinë e hidhur të largimit nga trumbu i të parëve të tyre.

Sot në Çordol ekzistojnë muret e ndërtesave të shkatërruara në një sipërfaqe rreth 30 dylymësh. Grumbuj murishesh. Deri vonë ka patur puse. Dallohen dy puse dhe muret e Kishës së Shëngjergjit. Banorët e këtij vendbanimi ndodhen në Besarabi, Moldavi e gjetkë. Edhe një gojëdhënë tjetër nga Çordoli i Pleshishtit.

Thonë se xha Veseli (Abeshi) në ditën e Pashkëve u drejtohet bashkëfshatarëve: -Mor, për të ardhur do të vij se s'bën dhe do ta fillojmë nga Maçollët e do të dalim në Ruhot, më pas tek Spirollarët e

Naqet, por unë kam një kërkesë. Xha Veseli ishte një plak i mençur, i urtë, me autoritet në fis e në fshat, i urtë, me autoritet në fis e në fshat.

-Ore vëllezër, nuk kam asnjë hall: as për bukë e as për para. Ju e dini se kam atë arën te kodra e Kulirës, që quhet Shëndëlli. Sa vjen koha për ta korrur, asaj i bie zjarri, jo nga njerëz...Atë vetëm Zoti e di. Prandaj kam ardhur t'i lutem Zotit edhe juve dhe t'ju them se atë tokë do t'ia fal vakëfit. Kjo është dhe arsyeja që Pëllumb Dehar Abeshi ka kontribuar për rindërtimin e kësaj kishe që në vitin 1991.

Pleshishti ka vërtet një histori të pasur, të pahlmutuar, ky është vetëm fillimi. Banorët te këtij fshati janë marrë me emigracion, si në Rumani, Australi. Spiro Maçolli ndenji 23 vjet në Australi dhe u kthye në vitin 1959, Gjok Naqe (Mokrari) në Rumani dhe u vra më 1916, Pani Spirollari ka humbur në emigracion në vitet 1897-1898. Shkolla shqipe në këtë fshat është hapur në vitin 1919 me Abetaret e Gjokë Mokrarit. Djemtë e këtij fshati vazhdonin ta ndiqnin shkollën në Trebinjë dhe më vonë në shkolla të tjera. Zafir Spirollari kurs ndërtimi në Rumani, Todi Josif Spirollari shkollë ushtarake në Itali Pandeli Maçolli shkollë amerikane të Kavajës, dega Pyjore Mësuesët e parë kanë qenë Mihal Bulku dhe Jovan Gjergo Maçolli. Pleshishti nga viti 1927 qendër komune, xhandarmarie me një të quajtur Jani Thana nga Përmeti dhe në vitin 1945 qendër Lokaliteti Kështu mund të rradhim pa fund të dhëna për historinë e këtij fshati. Në këtë fshat është krijuar Çeta e Batalioni i Mokrës. Ky fshat i dha luftës dëshmorët: Jovan Gjika, Llazi Pjetri, Pandi Degërmeni,

Mihal Pani Spirollari, Mistokli Naqe, Hydri Abeshi.

Një nga bijt e këtij fshati, i njohur në Mokër, por edhe më gjerë në rrethin e Pogradecit ishte dhe Zafir Mihal Spirollari.

## Xha Zakua, Një portret i munguar...

U lind në Pleshishtë në vitin 1907 dhe u nda nga jeta më 28 shkurt 1983 në moshën 73 vjeçare. Të gjithë ata, që e kanë njohur dhe duan ta njohin personazhin e shkrimit tonë Zafir Spirollarin (xha Zakua, por edhe xha Zaku, i thoshin disa të tjerë.) do ta gjejnë atë këtu midis rrjeshtave të këtij shkrimi. Në memorien e atyre, që e kanë njohur nga afër atë, ai shfaqet një njeri i thjeshtë dhe gjithmonë me buzën në gaz, pasi ai njihej si hokatar popullor. Njeri i thjeshtë, me cigaren në buzë apo në një dorë, pasi në njërin do ta shikojë me një çantë, pasi ai kreu për shumë vite detyrën e taksidarit, siç quhej atëhere në sistemin monist. Një karakteristikë tjetër e xha Zakos ishte se ai preferonte të vishte robra me ngjyra të çelura në gri, me një kapele, strehën e së cilës e ngrinte pak dhe mbi ball i dilnin një tufë flokësh me shumë të zbardhur nga koha dhe jeta. Ishte i njohur dhe i mirëpritur, pothuajse, në të gjitha familjet mokrre. Këtë cilësi ia kishte dhënë sjellja e tij hijshme dhe detyra. Për këtë flasin me respekt të gjithë ata, që e kanë njohur nga afër. Xha Zafiri (Zakua) që në moshën 17-vjeçare në vitin 1924-1930 shkoi në kurbet në Rumani. Pas kthimit nga Rumania fillon të merret me punë të ndryshme dhe të aktivizohet me problemet aktuale të kohës. Shërbimin ushtarak e kryen në Ministrinë e Shëndetësisë. Dr. Jani Basho e mori shoqëruar. Më vonë e merr menaxher për ndërtimin e shtëpisë private duke marrë mjeshtra ndërtues nga fshati. Më vonë në vitet 1933-1934 ndërton shtëpinë e tij në fshat me mjeshtra nga Pleshishti dhe Podkozhanit. Në vitet 1934-1941 punon në një kompani italiane në Kuçovë, ku bëhet dhe drejtues punimesh. Kështu nga viti 1942 dhe deri në Çlirim kryen detyrën e kryetarit të Këshillit. Arrestohet nga forcat kundërshtarë dhe dërgohet në burgun e Elbasanit, ku ndodheshin 140 burra nga Mokra e Pogradeci, të cilët i liron nga ky burg Petraç Pekmezi, fillimisht 70. Nga viti 1945 për shumë vite me radhë kreu detyrën e taksidarit për zonën e Mokrës.

Xha Zakua u nda nga jeta si njeri i nderuar dhe i respektuar në të gjithë Mokrën. Ai la pas një model të një jete me sakrificë në emër të jetës, të familjes, të shoqërisë, por edhe më gjerë.

**Shënimi:** Materiali për këtë shkrim është marrë nga studimi në proces qindra faqesh me autor Lefter Spirollari titulluar "Etimologji dhe Histori"

## DEMIR ELEZI, PUNETOR E I PALODHUR

Nga Sami LEKA

Kalojnë vite e dekada, por njerëzit që ia kushtuan jetën punës në shërbim të ndërveve nuk harrohen, i tillë është edhe Demir Harun Elezi.

U lind në Velçan, më 31 Mars 1950. Mësimet e para i mbaroi në vendlindje. Qysh në moshë të vogël Demirin iu nguliten nocionet e punës. Nga vështirësitë ekonomike që

përjetonte familja e tij, ai gjithmonë mendonte se vetëm me punë e dritur rregullohet çështja e jetës. Ende i ri në moshë ai, si bashkëfshatarët e tij, u vendos me punë në stabilimentin e sharrave Bishnice.

Fillimisht si punëtor e me vonë si kuzhinier, detyrë të cilën e ka kryer me ndërgjegje të lartë. Jeta dhe puna midis punëtorëve Demirin e ka kalitur shume.

Demiri ka gjashtë motra Fer-



iden, Selimen, Zabikori, Nafien, Qamilen, Safien edhe një vëllë, Hekuranin. Te gjithë të martuar me nipër dhe mbesa.

Vetë Demiri është martuar me Luljeta Gjaci nga Kukuri i Gramshit, e bija e Emin Gjaci.

Me martesë kanë lindur tre

djem të cilët i kanë rritur e edukuar e arsimuar. Iliri dhe Dritani me punë në Greqi, Algerti me punë në Pogradec.

Në vitet 1969-1970 Demiri ka kryer kurs kualifikimi për profesionin kuzhinier në Vlore. Por Demiri gjithmonë ka qenë kërkuar në vetvetë.

Me shume sakrificë mbaroi shkollën e mesme në Proptisht.

Puna e punëtorëve në pyje ka qenë e vështirë, me orar të zgjatur për vetë kushtet e terrenit të pyjeve.

Dite e nate me kushte atmosferike të ftohte, me trashësi dëbore e shira të shumta. Në këto raste Demiri dite e nate qëndronte në gatishmëri për ta mbajtur lokalit.

hapur me mjete ngrohëse si në sektorët Rovje, Uje i Ftohte, Talle e etj.

Mbas proceseve demokratike në vendin tone në vitet 1991-1992 Demiri kthehet në Velçan.

Ndërton një lokal të thjeshtë në shërbim të bashkëfshatarëve të tij. Shpesh here nga ftesat që kishte ai u shërbente për dasma ditëlindje etj.

Nga këto shërbime te Demirit bashke fshatarët kanë mbetur të kënaqur.

Me vonë si gjithë të tjerët edhe Demiri u shpërngul nga vendlindja në qytetin e Pogradecit me punë kuzhinier në një lokal afër agjencisë.

Pritja e përcillja, buzëqeshja e Demirit me klientët është e dashur e afrueshme. Te duket sikur ju thotë mokrarëve kudo ku janë: punoni për familjen tuaj, për Mokrën.

Qëndroni kryelartë dhe mos e përluini veten për ta bërë Mokren ashtu si e kanë ëndërruar bijtë e bijat mokrre.

Me këtë rast i urojme Z. Demirin, familjes së tij, motrave, vëllait, jete të lumtur në punë e në jetën e përditshme!



## FAMILJA E QANI SULËSTAROVËS NË POGRADEC

Nga Teuta SULËSTAROVA

Im gjysh Qani Sulëstarova ka qenë një nga njerëzit më të pasur të Pogradecit, ndaj edhe babai im ishte një prej bejlerëve të qytetit. Të qenit "kulak" ishte arsyeja e parë që u goditëm nga sistemi komunist dhe morëm emrin "të deklasuara". Një pjesë e pasurisë mu konfiskua ndërsa disa prej kushërinjve të babait, djem xhaxhallarësh, ishin aktivizuar me Ballin Kombëtar, dhe duke i quajtur eksponentë të Ballit, detyrimisht që pasojat ishin të pashmangshme. Nga mama isha me mbiemrin Hysenbegasi, edhe këtë familje kulakësh, por tejet të persektuar nga regjimi komunist. Këto ishin arse që Brigada e Parë Sulmuese, dy herë ka djegur shtëpinë tonë në Pogradec. Normalisht ne duhet të ishim në hasmëri me Shehët pas gjithë atyre gjërave që na kishin ndodhur. Por në "90-n gjithë ai inat u kthye në një bashkim gjaku, sepse martesë ime me Kujtimin i ndryshoi shumë gjërat. Punoja si mësuese e cilkit të ulët në fshatin Mokër të Pogradecit. Isha e ndërëgjshme që në kushte të tjera mund të kisha bërë një zgjidhje tjetër.

# Kujtimi i fundit i një NENE

Nga Bedri BLOSHMI

Sot mar nje telefonat te hidhur, nje telefonat te cilen nuk kisha deshire as njeherë ta degjoja. Alo, pergjigjem urdhero. Bedri Hamdiu jam te njoftoj.... Telefonata u nderpre nga fjalet, zeri u mek. Ky ze i dridhur kuptoheshe lehte se ishte penguar nga lotet te cilet nuk donin ta lejonin te nxirrte fjalën e hidhur nga goja e nje djali per nenen e tij. Mora ne numerin qe me moren, Hamdi me thua çka ndodhur pse je kaq i brenkosur, Tetja si eshte fole me thua, zeri nga ana tjetër vinte gati i fikur nje ze qe kuptoheshe leht qe frymarrja e pengonte te dilte. E megjithate Hamdiu gjeti force e mposhti pengesen e frymarrjes dhe vazhdoi Bedri "Tetja na la" varrimi behet neser ( me 7 mars) ne oren 12:00. sapo degjova fundin e bisedes u ula te marr telefonin qe vazhdonte te binte zilla ne toke nuk kuptoja fare se si dhe kur me kishte rene telefoni nga dora aq shume u trondita. Sot mora lajmin e keq Tetja nderroi jete. Nje zonje qe gjithë jeten kaloi me shami te zeze ne koke. Nje zonje qe e la familjen e saj midis loteve dhe dhimbjeve se gati familja e saj ( nga xvarishti) ishte ne fikje e siper nga plumbat qe kishin hedhur terroristet komuniste ne kete dore fisnike qe luftonte vetem per atedhehun e saj nga pushtuesit e asaj kohe, ku e gjithë bota ishte trazuar, qe krijoi lume e liqene gjaku. Po, sot nderroi jete ( xhaxhaica) bashkshortja e Hasan Blloshiu. Nje burri fisnik i zgjuar me teper sec duhej per kohen i urte, nxitone me ngadal kurru nuk e nxirrte fjalën nga goja pa e pertypur disa here. Po si do e shkonte Tetja jeten e saj ne derën patriotike, besnike ne familjen e madhe te degjuar te Blloshmeve. Ne qershorin e 1952 ne shtepine e Selman Blloshmiu ja behu policia kontrollon e shakterroi çdo gje ne kete shtepi, sekuestroi gjithë gjene e gjalle qe kishin, lope, kuaj dhe bageti te imta. Sekuestroi luge e piruna, pjata e deri tek legeni qe rrinte ne fundin e korridorit. I thone gjyshit kemi arrestuar Hasanin sepse ka strehuar diversantin Bardho Leka dhe diversantin tjetër Sabri Debrova. Tetja (Fitretit) kishte lindur dy djem Hysnin dhe Ham-

dine fare te vogel disa muajsh. Hasanin (bashkeshorti) denohet me 20 vjet burg. Familja jone jetonte nen peshen e temerrshme te presionit dhe te frikes nen temerrin e detyrimeve ndaj bandes sunduese te vendit. Te gjithë ne u rritem bashke me vuajtje e halle duke u bere balle gjithë te keqjave qe na vinin nga banditet komuniste. Ne vitin 1961, prap siguri mi mebrrii ne kullen e Blloshmeve kete radhe kishin arrestuar babane tani dy vellezer ishin ne burg dhe dy ishin jashete perpiqeshin te mbanin femijet e Hasanit dhe Samiut por dhe per ti ndjekur e ndihmuar te burgosurit. Ne korrik te 1965 lirohet nga burgu i Burrelit Hasani bashkeshorti i Fitretit. Ne nuk i kishim pare as njher. U gezova shume e kur e pame kete burra me pak mustaqe e me ball te zbuluar i kishim rene floket. Na mblodhi prane vatres e nuk reshete se perqafuari e duke na puthur. Ca ishim te gezuar e ca qanin, gjyshja thithte çibukun e ndersa duart i hishte shpesh mbi kokat tona duke perqafuar te birin qe kishte kaq vite pa e pare. Xhaxhai i pergjigjej gjyshes (nenes se vete) duke u drejtuar nga mamaja, mos u merziteni se dhe Samiu do lirohet shume shpejte nga burgu. Fitretit ulur prane mamase diç i thoshte he mos u merzit çka bere Zoti femijet do i rrisit bashke. Ne keto çaste hapet dera ishte Vili, vinte nga Elbasani nga shkolla mbasi e perqafoj xhaxhane u ul prane nesh. Xha Hasani mbasi tha dy apo tri here marshalla per Vilsonin vazhdonte te pyeste me mesimet si po shkon, mire pergjigjej Vili. Meso nipçe meso kujdes me shoket ne diskutimet qe beni hap syt jo me cilin do bej biseda. Vitet kaluan jemi ne 1976 prap siguri mi tek familja Blloshmi arrestohen une, me 1 prill, me 5 gusht arrestohet vellai Vilsoni, me 31 gusht arrestohet Genci. Dy te fundit pushkatohen ditën e internimit te gjithë familjes tone (ishim prap bashk) sapo i çojne ne vend internim hekura parape arrestojne Hasanin ( bashkeshortin e Fitretit) dhe e dergojne ne birucen qe kishte qen i nipi (Vilsoni) lidhur koke e kembe 3 dite e denojne 10 vjet. Vdes ne burg ne Spaç ne 1982. fitretit bashke me dy djem e saj parp vetem. Ishin fer me mamane time ja tani dy zonja te plakura nga hallet e vuajtjet bisedonin per gjemen qe i ka zene. Nje jete me dhim-

bje nje jete plumba dhe hekura, lot dhe vaj ne kete familje. Ja tani ora po shenon 12:00 njerzia kane ardhur nga do, eshte shkullur i gjith fshati qe kjo halle e madhe sot niset ne boten tjetër duke marre me vete vetem dhimbje, brennga, lot e psheretima. Arkivoli qendron ne mezin e dhomes gjysem i hapur per rreth tij qajne e ulerijne djemt e nusët, niper e mbesa, qajne me ligjet e vdekjes i numerojne nje mije e nje te zezat qe ka hequr, vetem halle dhe derte. Te gjithë jane te shtangur ora po kalon makina e varrimit pret me deren e hapur, autobusat mbushur dingazi presin qe te nisen. Te gjithë te mendshem thithin pa pushim cigaret e tyre. Nuk po e kuptojne pse xhenazeja nuk po del nga shtepia. Lala rri i shtangur tek dera e me shamin ne dore fshin lotel here pas here. As kush nuk guxon ti afrohet arkivolit nuk ka force ne bote ti largoj djemt e nusët e femijet e tyre per ta shkullur arkivolin. Ata me luten te mos e marrim dhe pak Teten na e ler, ne as dhe ti skemi per ti thirru me Tete. Te kujtohet para 10 vjetesh kur vdiq mamaja qe ti se leshoje arkivolin, te kujtohet qe vetem qaje e thoshe do futem dhe un ne arkivol nuk e le mamane vetem. Po tani pse po na e merr Teten prit dhe pak. U ula menjane dhe thithja pa pushim cigaren ne çast mu afrua babai, motra e shume te aferm te tjere. He Bedri çfare do bejme do nise mi te bejme varrimin. Hoxha qe do falte xhenazene e dergojne ne banesen e fundit. Pash qe te qarat e klithmat po qetesoheshin mendova se keta u lodhen duke qare e renkuar u afrova kapa arkivolin ne njerin cep ju fola pak me ton Hysenit, Hamdiut. Hajdeni kapeni se do nise mi. As kush nuk me kundërshtoj u nise mi per ne varreza, kaluam prane varrit te gjyshes, prane varrit te gjyshit , prane varrit te mamase qe dukesh ne fotokrafi se priste Teten ju afruam varrit te xhaxhait ( Hasanit) ku per krah ketij ishte hapur nje varr tjetër aty do pushonte perjetesisht Tetja ne krahe te bashkeshortit te saj e meqe nuk e shijuan jeten e tyre ku jetuan me shume te ndare se sa bashke dhe tani fati nuk u tregua aq i pameshireshem beri te jetojne perjetesishte bashke pa u trazuar nga as kush ne nje koder lendine perballe shtepive ku jetonin dhe tani jane boshe e me dritare te hapura gati te rrenuara.

Tete Lamtumire e te qofte i lehte dheri. Lamtumire.....

LAMTUMIRË DOKTOR LUTI, JU DO MBETENI PËRGJITHMONË NË MENDEJT TONA

## LUTFI VRETO, NJË MJEK DHE NJË GOJËËMBËL PËR CILINDO



Lutfiu u lind në fshatin Farret të Librazhdit më 8 shtator 1971, nga një familje me tradita të larta patriotike.

Arsimin fillor e kreu në fshatin e lindjes dhe atë të mesëm në qytetin e Librazhdit. Për rezultatet e mira që kishte arritur fitoi të drejtën e shkollimit në Universitetin e Tiranës për mjekësi duke e përfunduar me rezultate shumë të larta në vitin 1994. Ky profesion i nderuar i një mjeku i dha më shumë mundësi për t'u afruar me njerëzit me hallet dhe me shqetësimet e tyre. Karriera e tij në mjekësi fillon në zonën e thellë të Stravajit dhe pas një specializimi në vitin 2001 fillon punë në urgjencën e kardiologjisë, në qytetin e Tiranës. Për arritjet dhe nivelin e tij të lartë kalon si mjek i qendrës shëndetësore në qytetin e Vorës dhe zonën e Prezës. Këtu ai dha maksimumin e punës në interes të shëndetit të këtyre banorëve, deri në ditët e fundit të jetës së tij. Temperamenti i tij i dashur, i respektuar, i afruar me cilindo, niveli dhe besimi në vetëve për profesionin, e bëri që të fitojë besimin dhe respektin maksimal të gjithë banorëve dhe qytetarëve të cilëve ai ju shërbeu. Ai jo vetëm i vizitonte e mjekonte e

por me ëmbëlsinë e tij u'a hiqte shqetësimin që kishin në trupin e tyre. Luti nuk ishte vetëm një mjek i mirë por edhe një qytetar shumë i angazhuar në mjediset e lagjes ku banonte, një familjar i shkëlqyer, një mikpritës dhe me një respekt ai do të mbetet i pa harruar më mendjet tona. Po ja që një sëmundje e pa shërueshme e bëri që ai të largohet para kohe nga kjo jetë. Për një kohë shumë të shkurtër ai vetë dhe familja, prindërit dhe farefisi bënë të pa mundurën për ta shëruar. Një ndihmë e madhe dhe e pa kursyer ju dha, duke u mjekuar e kuruar në një spital të Italisë të cilët i respektojmë dhe falënderojmë për ndihmën e dhënë.

Lutfiu ndërroi jetë në moshën 41-vjeçare duke u larguar përgjithmonë nga babai Hyseni, nëna Shyqyria te cilët e rriten e edukuan por nuk arritën te shohin plotësisht jetën e tij, u nda nga familja, nga djali dhe goca të cilët janë në moshën e vogël dhe më shumë se kurrë ata kishin nevojë për gojën, për mendjen, e tij të ndritur, u largua nga gjithë fisi, nga shoqëria e tij e madhe, kudo që ai e kishte dhe e respektonte.

Këto që themi u panë dhe u treguan

me datën 25 janar në ceremoninë e varrimit të Lufi Vretos. Në atë ceremoni mortore, pavarësisht kohës dhe largësisë, erdhën nga Mokra, Stravaj, Korça, Pogradeci, nga Farreti që e lindi, e rriti e mësoi dhe e kulturoi, nga Quksi, Elbasani e Durrësi Vora dhe Tirana pra ky ishte ishte respekt dhe dashuria për një njeri të ri në moshë dhe me një zemërbardhësi të madhe e të mrekullueshme. Ky ishte takimi i fundit me këtë njeri, me këtë mjek prandaj erdhën për t'i bërë respektin dhe përcjelljen e fundit banorët e Prezës e Vorës me në krye Kryetarin e Komunës. I falënderoj edhe në emër të familjes e shoqërisë.

Lutfiu do na mungojë të gjithëve por më shumë babait, nënës, veçanërisht familjes që kishte lidhur jetën me të, fëmijëve që i mbante për dore, vëllezërve dhe motrës, dhe gjithë fisit e shoqërisë. Por ja që jeta duhet e secilit duhet të vazhdojë, edhe pa njeriun e tyre të dashur e shumë të respektuar. Të gjithë duhet të gjejnë forca për ta kaluar këtë dhimbje shume të madhe. Edhe ne stafi i gazetës "Mokra" ju shprehim ngushëllimet tona të sinqerta, familjes dhe gjithë të afërmeve, për këtë humbje të madhe.

Zabit ÇUKU

Ishite fund vitit 2006 kur në apartamentin tonë mi dis shumë banorëve familjare erdhi edhe një djalë i ri. Pa u njohur fare me ne ai çdo dite me çantën e dorës, zbriste shkallët dhe na përshëndeste, mirëmë-ngjesi dhe ditën e mirë. Ky ishte Lutfi Vreto, ose doktor Luti i thoshim ne banorët e palatit Nr. 8 Hyrja Nr. 4 në Rrugën "Selman Riza", në Tiranë. Por ja nuk thonë kot se njerëzit e mirë nuk ndihen, nuk vlerësohen, nuk njihen, por vetëm mbeten ne kujtesën e cilitdo pas largimit nga jeta, por ai problematiku ose i keqi jeton dhe nuk vdes kurrë. Doktor Luti nuk arriti të gëzojë deri në fund jetën e tij dhe të gëzojë familjen e fëmijët e tij.



# Homazh për Bektash Dukën, njeriu që i dha nder vendlindjes dhe qytetit

Njeriu i sakrificës që s' duhet harruar, ky është Bektash Duka, që i dha nder vendlindjes dhe qytetit ku jetoi

Nga Beqir PUPA

**I** lindur dhe i rritur në fshatin Bletas rrëzë Malit të Thatë, që i këndoi Lasgushi i madh. I edukuar me traditat patriotike e atdhetare të familjes që në vogli shquhej midis shokëve si në shkollë dhe jashtë saj. I dashur dhe i respektuar me shokët e rinisë, ku kaloi një pjesë të saj me plot aktivitet e sidomos ato sportive për aq sa mund të bëheshin në fshat asaj kohe.

Të shkruash për Bektashin dhe profesionin e bukur dhe human të shoferit besoj se është një nder i madh, sepse shoferi ashtu si mjeku njëherë gabon. Kështu ngjau dhe me shoferin shembullor Bektash Duka. Bektashi ëndërronte të bëhej shofer dhe u bë shoferi i parë i fshatit dhe i rrëzës së Malit të thatë. Më vonë në sajë të kujdesit të vëllait të madh Shefqetit u largua të banonte në qytet, por kurrë nuk e harroi fshatin e lindjes Bratomirën. Për Bektashin flasin dhe ruajnë shumë respekt bashkëfshatarët e zonës së Malit të Thatë dhe qytetarët e Pogradecit. I dashur me të gjithë dhe profesionist i shkëlqyer, kurdoherë i palodhur sidomos me puntorët e minierave nga Alarupi në Çervenakë, nga Petrusha në Dardhas apo Podkozhan e Vër-



dovë në rrugë të ngushta dhe të vështira. Ishte kënaqësi të udhëtoje me autobuzin e tij në linjat Pogradec-Korçë apo Tiranë dhe qytete të tjera nëpër Shqipëri. Ai

nuk ndiente lodhje dhe me buzëqeshje e dashamirësi jepte dhe përparësi për kujdesin gjatë udhëtimit. Bektashi ishte i papërtuar në punë, punonte dhe jashtë orarit, në diell dhe në shi, në borë dhe stuhi dhe madje kurdoherë, kur ishte nevoja. Për këto cilësi të mira punëtorët shpesh në biseda e kujtojnë me respekt. Edhe sot fshatarët e Malit të Thatë dhe qytetarët e Pogradecit thonë se shoferë dhe makina ka shumë, por të rrallë janë si Bektashi. Ai nuk mundi të jetonte e të punonte në këto rrugë që çdo ditë asfaltohen e kanë shkuar në çdo qendër fshati. Ai nuk mundi të udhëtonte as në autostradat, që ndërtohen apo në rrugën e Kombit drejt Kosovës. Nganjëherë dëshirat dhe ëndërrimet në jetë nuk realizohen. Priten në gjysëm. Dhe ja kështu u nda nga jeta aksidentalisht, por në mënyrë të dhimbshme, shoferi shembullor Bektash Duka. Në pamundësi të kishte eliminuar difektin në autobus sakrifikoi jetën, duke shpëtuar jetën e të gjithë udhëtarëve. Ai u nda për të mos vdekur kurrë, veprim kaq fisnik dhe human i këtij shoferi shembullor.

Kështu merr kuptim jeta e vërtetë për njerëz të tillë si Bektashi ynë i paharruar. Njerëz të tillë nuk duhet t'i harrojë as shoqëria në memorien e saj.

## Nurie Biba, nëna e paharruar mokrare

Nga Petrit BUNA

**G**ratë e rrethit të Pogradecit, të qytetit, krahinave të Mokres e të gjithë zonave të tjera, si gjithë grate e Shqipërisë, kane

Një kontribut të madh e me vlerë gjatë Luftës Antifashiste NÇL për çlirimin e vendit nga pushtimi i huaj nazifashist. Gjatë luftës, ato kanë shënuar një faqe, të lavdishme guximi, trimërie dhe heroizmi të pashoq.

Një nder to, që ka lënë emër të nderuar në Mokër, por edhe me gjerë për kontributin e saj të madh gjatë LANÇ - it është edhe Nurie Ali Biba.

Nuria u lind në vitin 1889 në fshatin Stranik të rrethit të Librazhdit, në një familje të varfër, por të ndershme e atdhetare. Pati një fëmijëri mjaft të vështirë e plot halle! Babai Aliu, së bashku edhe me të vëllanë e saj, Islam Allkon, emigruan në Turqi për arsye ekonomike, për të siguruar bukën e gojës për familjen e tyre. Atje mbeten, e kurrë me nuk u kthyen në shtëpi. Mes



skamjes dhe varfërisë ajo së bashku edhe me të motrën, Salijen, u rriten me shumë veshitësi nga nëna dhe të afërmit e tyre. U martua me Hasan Biben në fshatin Velçan të rrethit të Pogradecit. Fisi Bibaj ishte me emër të dëgjuar me Mokër, ish një fis i madh e me rreth miqësor të gjerë e mbi të gjitha ishte fis patriot. Nga martesja e tyre, çifti pati pesë fëmijë, një djalë dhe katër vajza. Familja Biba u lidh shumë shpejt me lëvizjen Antifashiste, qysh

në fillimet e saj.

Ndonëse lufta e gjeti nene Nuriën në një moshe jo fort të re, ishte mbi pesëdhjetë vjeç, kur ajo u bë aktiviste e flaket e luftës për liri. Qysh në fund të vitit 1942 dhe në fillim të vitit 1943, kohë kur familja e saj u lidh me lëvizjen, ajo u bë mbështetëseja më e madhe e bashkëshortit dhe së bashku edhe me të gjithë familjen e saj u përfshinë.

Në lëvizjen për çlirimin e vendit nga pushtuesi i huaj. Në një kohë mjaft të shkurtër ajo u bë një propagandiste e shquar e luftës, punonte me durim me njerëzit e rrethit familjar, në fillim dhe me pas edhe me gjere, me gratë e fshatit. Fjala e saj zinte peshe dhe shtonte besimin e atyre që e dëgjonin.

Shtëpia e saj u bë baze e sigurte e luftës çlirimtare, priste e përcillte partizanet me ushqime, strehim e veshmbathje. Për punën dhe kontributin e saj të madh gjatë luftës, ajo u zgjodh kryetare e gruas antifashiste të fshatit të saj, detyre të cilën e kreu me shumë përgjegjësi e

përkushtim të jashtëzakonshëm. Pas kësaj puna e saj u rrit se tepërmi, shkante për të punuar shtëpi me shtëpi me gratë e fshatit, por shkante edhe në fshatrat afër Velçanit si në Buzeahishte, Laktesh, Losnik, etj. shpërndante trakte kudo që vinte.

Vlere shume të madhe merr edhe fakti se e gjithë familja dhe f'isi Biba dha kontribut të madh për luftën dhe u përfshi tersisht në të. Kështu, bashkeshorti i saj Hasani ishte në njësitin e fshatit, vëllai i burrit të Nuries, Idrizi dhe i nipit i tij Harizi u rreshtuan në Brigaden e I dhe 20 - S, djali i motres së Nuries, Luman Leka ishte kryetar i Këshillit NÇL të fshatit Senisht në Moker, etj.

Rast shume i veçante jo vetëm në krahinën e Mokrës, në rrethin e Pogradecit, por ndoshta në të gjithë vendin është edhe fakti, se edhe të kater bashkëshortët e vazave të nene Nuries, kane qene të rreshtuar në Brigadat partizane dhe kane luftuar me arme në dore kundër pushtuesve të huaj deri në çlirimin e plote të vendit, si Salo Rapçë nga Velçani, Osman

Bufi nga fshati Kriçkovë, Xhemal Kapri nga Goliku, dhe Shaban Zajaku nga fshati Stravaj i rrethit të Librazhdit.

Nene Nurija jetoi gjate, u nda nga jeta në vitin 1985, duke lene pas gjurme të pashlyera në veprimtarinë e saj në shërbim të çlirimit të vendit dhe fitores së lirisë. Puna e saj do të kujtohet kurdoherë me mirënjohje nge brezat që vijnë.

Punen dhe veprën që la pas nene Nuria po e ndjekin me shume besnikëri trashëgimtarët e saj, të cilet militojnë me plot dinjitet dhe po japin kontributin e tyre si pasardhës veterani në organizatën tonë të nderuar të veteraneve, si Etem Hapçe, i cili është i zgjedhur kryetar i Këshillit Zonal të veteraneve të Komunës së Velçanit, Barjam Leka, i zgjedhur anëtar i Komitetit të veteraneve të rrethit dhe veprimtar i dalluar në lagjen 5 të qytetit si dhe bashkëshortët inxhinierë Violeta dhe Riza Bufi, të cilët i bëjnë nder të qenit anëtarë të organizatës sonë të veteraneve të rrethit tone, kontributi i përbashkët i të cilëve i shërben me se miri mbrojtjes me besnikëri të idealeve të shenjta të luftës për liri dhe transmetimit të tyre të sigurte në brezat pasardhëse që vijnë pas.



ME RASTIN E 70-VJETORIT TË KRIJIMIT TË ÇETËS PARTIZANE TË MOKRËS (MARS 1943- 2013)

# KONTRIBUTI I ÇETES SE MOKRËS, ME KOMANDANT RESHIT ÇOLLAKU NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE



**Nga Llazi TONA**  
Oficer i llogjistikës në pension

Heroini i Popullit” Reshit Çollaku u lind më 7 tetor 1916 në qytetin e Pogradecit, në një familje me tradita të larta patriotike, njerëz të punës e me ekonomi të konsoliduar. Babai i tij Isuf Çollaku së bashku me atdhetarë të tjerë, ngritën flamurin për pavarësi në Pogradec më 1912. Në vitet e Luftës së Parë Botërore mori pjesë me armë në dorë kundër sovranistëve serbë, bullgarë e austrohungarezë ku tregoi trimëri të rrallë. Ishte i zgjuar. I dëgjohej fjala në rrethet shoqërore. Mbështeti Qeverinë e Sulejmanë Delvinës, të dalë nga Kongresi i Lushnjes.

Prindërit Çollaku i edukuan fëmijët me dashuri për vatan, Atdhe, komb e Flamur e urrejtje për çdo pushtues të huaj.

Reshti pasi mbaroi shkollën në vendlindjen e tij shkon në shkollën e oficerëve Tiranë. Këtu ai fiton simpatinë dhe respektin e shokëve, të cilët e dëgjonin dhe e respektonin. Në vitin 1933 shkon për studime të larta në Akademinë Ushtarake në Modena të Italisë. Atje zhvilloheshin mësimet të një niveli të lartë tekniko-shkencore ushtarake. Atje zhvillohej strategjia dhe taktika e luftërave që u përgjigjej kërkesave më të përgatitura e më të reja në fushën e luftimeve, me organizim dhe drejtim të përsosur ushtarak. Dhuntitë që ia kishin falur me bollëk natyra, zgjuarsia, mprehtësia, shprehja e rrallë e studimit, me të cilat ishte pajisur, sigurisht gjatë shkollimit dhe mësimi i rregullt në kushtet e një discipline që i dallonte nga shkollat e tjera, do të bëjë të mundur Reshit Çollakun, që të pajiset me një varg njohurish në fushën ushtarake evropiane.

Reshti çmonte shumë librat e njerëzve të mëdhenj si: çiftin e ndritur Aristotel-Platou, të filozofisë së lashtë Aleksandrin e Madh të Maqedonisë, një nga personalitetet më të rëndësishme në histori, Demostenin, Napoleon Bonaparti, që ai në atë kohë kërkonte Evropën të bashkuar.

Akademisti Reshit Çollaku nuk e ulte veten, para të tjerëve, por gjithmonë krenar, sepse ishte nga Ilirikumi apo Arbëria, që u kishte dhënë legjioneve romake dhe Bizantit shumë ushtarakë. Disa bënë karrierë dhe u ngritën në poste të larta drejtuese deri në perandorë, si: Deci (244-251),

Aureli (267-363), Mark Aureli Probi (276-282), Kostandini i Madh (306-337), Juliani (361-363)ë Anastasi i Durrësit (406-508), Justiniani I (450-527)ë Justiniani II (570-670), Justiniani II e shumë të tjerë. Me këta figura të shquara me origjinë ilire Reshti u njoh në gjithë procesin mesimor të artit ushtarak që zhvillohej në gjithë akademitë evropiane/ por, ai nuk harronte bëmat e heroit Evropian Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ku bota e krishterë e ka quajtur “ushtar i Krishtit”. Pak e dinë e shumë nuk e dinë se në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, se: “Skënderbeu mbrojti krishtërimin në Evropë për 25 vjet”.

Studimet në Akademinë në Modena të Italisë i shkonte me interesim të madh pa u shpëputur dhe nga qëndrimi i regjimit fashist në Itali, ai pa atje padrejtësinë shoqërore falsitetin e demagogjisë fashiste. Pra, në shpirtin e tij filloi të shtohet urrejtja kundër fashizmit.

Më 7 prill 1939, të premtën e zezë, në orën 4.30 minuta të mëngjesit hordhitë fashiste të Musolinit, filluan sulmin e tyre të pabesë kundër Shqipërisë. Agresioni i shëmtuar kundër një populli dhe një vendi paqësor e të pa mbrojtur, ishte në prologun e Reshilit. Ky pushtim ngjalli tek Heroi i Popullit një urrejtje të madhe për fashizmin gjakatar flamurit me sëpatën e Liktorit, Reshti ishte i pari ushtarak, i dha këtë përgjigje:

“Na ndjeni, zotëri, por ky flamuri nuk është yni, ai është krejt i huaj për çdo shqiptar të vërtetë. Prandaj ne skemi pse të betohemi”.

Thirret në komandën e Akademisë duke i premtuar se do ta ngrinin në komandant të regjimentit të fanterisë. Përsëri akademisti Reshit Çollaku nuk pranon duke ju përgjigjur:

“Zoti Gjeneral si mund të shkoj në vendin tim të komandoj regjimentin për të pushtuar Shqipërinë për të vrrarë popullin tim. Kjo nuk mund të bëhet”.

Për mos zbatimin e urdhrat dënohet një muaj arresti ushtarak brenda Akademisë.

Mbasi mbaron arrestin ushtarak nga major merr vendim për t’u kthyer në Atdhe. Ideja e tij ishte “Ngritja e popullit të Moskës dhe rrethina kundër pushtuesve fashistë.

Komandës së akademisë i kishite vajtur një telegram nga familja në të cilën shkruhej se e ëma e Reshit Çollakut ishte sëmurë rëndë dhe u lutej të jepej atij një leje për të ardhur ta shikojë.

Reshit Çollakut i jepet leje disa ditë e niset me një herë. Kur mbërrin në Librazhd takon Asim Zenelin i cili ishte oficer në repartin e atij qyteti, që dhe ai i kish mbaruar Akademin ushtarake të Modenës e që njihej me Reshitin. Mbasi përqafohen njëri me tjetrin biseduan gjerë e gjatë për pushtimin fashist të Sh-



qipërisë dhe se çfarë duhej bërë. Akademisti Asim Zeneli e porosi Reshitin që të mos kthehej në shtëpi se familja Çollaku survejohej nga sigurimstat fashistë italianë dhe pjalatëpirësit e tyre por menjëherë të hidhej në ilegalitet. Ashtu u tha dhe kështu u bë.

Kalon kufirin shqiptar dhe mbërrin në Beograd. Atje vendoset në Klubin e emigrantëve shqiptar.

Lidhur me këtë bëhet fjalë edhe në një dokument arkivor që mban datën 18 prill 1970 ku komandant major Luigj Venerandi në një raport i ligjonit tokësor të karabinierëve të Vlorës dhe grupit të Korçës për fletë arrestimit të nxjerrë nga gjykata ushtarake të Napolit për Reshit Çollakun i njoftonte Ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë, Komandës Eprorë të K.K.M.M. Tiranë, komandës së legjionit KKMM Vlorë.

“Më 13 mars 1940 pat arritur prej Gjiqit Ushtarak të Napolit kopjen e mandatit të arrestimit të ish nëntogerit të XII Regjimentit të Fantarisë, Reshit Çollaku, bir i Isufit lindur në Pogradec më 7 tetor 1916. Ky mandat qe dhënë më 22 fryer 1940 pse me vendim të gjyqit ushtarak në fjalë Reshit Çollaku, ishte dënuar me dy vjet e njëmbëdhjetë muaj burg për dezertim përjashta e për abuzim titujsh Dezertimin në fjalë ka ndodhur për sa rezulton, më 7 Nëntor në fjalë ka ndodhur për sa rezulton, më 7 Nëntor 1939, datë në të cilën Çollaku ka kaluar kufirin në juridiksionin e postave se KKMM, në Zerqan, ku ikën në Jugosllavi. Mbasi janë bërë hetimet përkatëse janë dhënë urdhra për me gjetë pjesëtarët e familjes, të cilët, janë porositë më

datën 22 mars 1940, me ushtrinë çdo presion mbi dorëzue, Reshit Çollaku rezulton se gjendet në Volero dhe duket se ka vendosur me ndjenjë atje se.

Në Pogradec ai ka familjen e vet. Pjesëtarët e familjes janë porositur dhe një herë por me ba që të dorëzohet i afërmi i tyre dhe kanë lajmëruar se prindërit do të ndëshkohen me internim nga policia në rast se i afërmi në fjalë nuk u dorëzohet”.

(AQSH, RPSH F-655. D48 f 1-2)

Kur u pushkatua dhe Jugosllavia nga Italia fashiste Reshit Çollaku kthehet në Atdhe në vendlindjen e tij. Në mbremje vonë hyn në shtëpinë e tij. Familja e pret me një gëzim të madh “E pamë si shumë të lodhur – tregon e motra – i rraskapitur e dremitur. Atë natë në shtëpinë tonë u grumbulluan gjithë familja e Çollakëve. Tërë natën nuk kemi fjetur fare duke biseduar me Reshitin e çmallur me të. Në bisedat Reshiti interesohej në mënyrë të veçantë për njerëz që i shërbenin fashizmit, hidhërohej shumë kur i përmendnin ndonjë të njohur.

## Çeta partizane e Mokrës reparti i organizuar luftarak

Ishte muaji shkurt 1942. Në Pogradec erdhën veç e veç të dërguar nga qarkori i Tiranës, shokët: Pandi Kristo, Petro Papi, Sotir Gura, Ymer Dishnica të cilët morën takim me Reshit Çollakun dhe biseduan me të për problemin e çetës së Mokrës. Aty nga 10-15 marsi erdhi përsëri një i dërguar i qarkorit të Korçës solli në celulën e Partisë në Pogradec vendimi për krijimin e çetës par-

tizane me 6 veta me komandant Reshit Çollakun.

Më mars 1942 komandant me Papa Dhimitër Kokoneshi, Liko Gjoni, Maliq Lufo, Papa Risto Potgozhani, Shefki Piskupati, Nexhat Tirona shkuan në Pleshisht të Mokrës së Sipërme ku ish mbledhur populli i krahinës e Reshit Çollaku u bëri thirrje për tu bashkuar me Partinë e për t’u inkuadruar në radhët e çetës partizane të Mokrës.

Çeta nga dita në ditë shtonte radhët e saj nga 6, në 12, 20 e deri në 150 partizanë. Ata vinin nga radhët e fshatrave, punëtoresh nga qyteti, intelektualë, studentë e nxënës. Kështu që komanda e çetës hartoi një program për aftësimin e partizanëve, rritjen e nivelit të tyre ushtarak. Çeta e Mokrës ishte jo vetëm një program i organizuar luftarak, që godiste me forcë armikun por edhe një shkollë edukimi dhe përgatitje.

“Çdo ditë bënim stërvitje – ka shkruar veterani i LANÇ Nuçi Tira, bënim përgatitje për qitje zbërthimin dhe mbërthimin e armëve pastrimin e vajojshen, ruajtjen mbërthimin e tyre. Por, nuk mbeteshim me kaq në përgatitjen tonë ushtarake. Ne mësonim dhe taktikën në luftë. Atë na e mësonte akademisti ushtarak dhe komandanti i çetës partizane Reshit Çollaku. Bënim gjithmonë stërvitje si të hapëshin skuadrat në formacione luftarake, si të stërviteshim, si të zinin pozicionet për të luftuar kundër aeroplanëve armike e si të hapnim zjarr kundër tyre e si të qëllonim mbi to. Bënim dhe përgatitje rreshtore bile edhe, si të ecnim në këmbë, sepse ne do të bëheshim një ushtri e rregullt në të ardhmen.

Eh ç’shokllë e madhe ishte çeta partizane e Mokrës”. Me një herë pas ngritjes së çetës komandanti Reshit Çollaku dha një ultimatum në të cilën midis të tjerave thuhet: “...Ju, xhandarë, brenda 5-6 ditëve, të largoheni nga krahina e Mokrës dhe Gorës. Në truallin tonë, fashizmi nuk ka vend. Flamuri i Shqipërisë duhet të valojë i lirë në malet tona. Nqs brenda këtij afati nuk jeni larguar, ju pret pushka partizane. Do t’i përveçojmë çerdhet tuaj, ku rriin të struktur”.

## Njësitë guerile në Mokër

Mbas krijimit të çetës partizane në krahinën e Mokrës u ngritën një varg njësitë guerile. Ato ishin grupe të vogla të armatosura të përbëra nga 10-15 veta në çdo fshat. Në krye të tyre zgjidheshin njerëz me përvojë, organizatorë, që kishin qartësi, pjekuri dhe vendosmëri. Njëri prej tyre ishte ngarkuar me detyrën e përgjegjësit ushtarak, që merrej me organizimin dhe veprimtarinë e njësitit gueril.

Komandantët e këtyre njësiteve kanë qenë: At-Dhimitër Kokoneshi në këngë, Tek Baç në Çezmën e vogël, Etem Haxhia në Çezmën e Madhe, Zyko Kalivaçi në Kalivaç At-Risto në Potgozhan Abaz Dragoi në Trebin-





Çeta e Mokrës, 1943

jë. Vesel Selca në Selcë. Thanas Maçolli në Pleshisht Liko Gjoni në Laktesh Maliq Lufo në Velçan Cene Mane në Losnik Riza Balliu në Slabinjë Hariz Leka në Proptisht Pasho Kullolli në Golik, Dervish Nofulla në Rrotokal, Serjan Pengu në Homesh.

Çdo njësit gueril kishte bazat e tij, të cilat u vendosën në vendet e afërta dhe ku jetonin anëtarët e njësitve. Ndërsa qendra kryesore e LANÇ e krahinës së Mokrës ishte Manastiri i Shën Mërisë në Llëngë.

Bazat ilegale shërbenin për mbajtjen e mjeteve luftarake, mjete propagandistike dhe si vend për stërvitjen për guerilistat. Veprimet e njësiteve guerile në Mokrë u zgjeruan shumë sipas detyrave të ngarkuara. Aksionet e tyre u dendësuan në lidhje me rrëmbimin e materialeve të armikut për nevojat e Luftës.

“Në muajt e parë të vitit 1942, fshat më fshat – ka shkuar veterani i LANÇ-it Zyko Kalivaç – e breg më breg në krahinën e Mokrës që ziente nga dëshira për luftë vinin Reshit Çollaku me shokët. Aksionet e njësiteve guerile në qytetet bënë jehonë. Prerja e linjave telefonike, djegia e depove të armikut e të tradhtarëve zgjonin tek ne dëshira për veprimtarinë në aksion. Një ditë vjen në Kalivaç Reshit Çollaku me shtatë shokë të tjerë. Në ndërtesën e vogël të shkollës në Kalivaç u mbledhën 25 burra.

Erdhi koha – tha Reshit Çollaku – që në Kalivaç, ashtu si në gjithë Mokrën, të ngrehini njësitë partizane në fshat. Si thoni ju shokë? Pyeti ai. Pyeti ai. Ne për një çast heshtëm, ishim shumë të emocionuar. Ishte momenti më i rëndësishëm në jetën tonë. Të gjithë prisnim në heshtje.

-Si mendoni shokë? – foli përsëri Reshiti.

Sa madhështore tingëllonte fjala “shok” foli përsëri Reshiti. Sa i zjarrtë ishte emri partizan.

-Jemi gati! Jemi Gati!

Kështu ju përgjigjën në atë mbledhje të vogël. Krijuaam kështu njësitin gueril të fshatit.

### Çeta partizane e Mokrës godet me furça armikun

Mbas krijimit të çetës partizane me komandant Heroin e Popullit Reshit Çollaku dhe me

krijimin e njësiteve guerile veprimet luftarake kundër pushtuesve fashistë me zonën e Mokrës u shumuan dhe u bënë më të forta dhe më dërmuese.

Aksionet kundër postare ushtarake dhe komunave pushtuese fashiste ishin pikënisjet kryesore të çetës për pastrimin e zonës nga qeverisja fashiste. Me 28.08.1942 Çeta partizane e Mokrës sulmoi kamionët ushtarake që transportonte shokët e interesuar nga Korça në Tiranë. Ja si e përshkruan “Zëri i Popullit” më 1942: “Në Grabovicë ku kishte dalë të priste çeta trime e Mokrës, pasi luftoi tre orë rresht kundër qindra milicëve e karabinierësh që lanë dyzina të plagosur e të vrarë u tërhoqën duke lënë vetëm një shok të vrarë”.

Ne këtë aksion për trimëri, guxim e shkathhtësi u dalluan partizanët Hetem Haxhiu, Dhimitër Ruvina, Gjok Lacka, Koli Gusko, Kristo Divjaka e tjerë.

“Atje pashë Reshit Çollakun që luftonte më këmbë – ka thënë veterani i LANÇ Nexhat Tirana – Ndron-te shpesh vendin dhe i qetë shtinte pa ndërprerje. Në profil me sy të ndezur me një tufë flokësh që i rrëzonte mbi ballë, i rreptë dhe i shkathët, ai dukej si një tigër”.

Një goditje të fuqishme kry-

en partizanet e çetës së Mokrës më 30 tetor 1942 në rrugën Elbasan-Qafë e Thanës, 4-5 kilometra nga Prenjasi, kundër një autokolonë ushtarake, prej afro 100 kamionësh të ngarkuara me bomba avioni. Çeta përpara se të zinte pritën kishte bllokuar xhadenë. Duke rrokullisur shkëmbinj të zuri udhën dhe pastaj hapi zjarr të dendur mbi armikun i cili shkaktoi rrëmujë dhe panik në radhët e ushtarakëve italian. Nga zjari i fuqishëm u shkatërruan 4-5 automjete dhe u vranë 20 armiq pa llogaritur plagosjet. Kur erdhën në ndihmë të të sulmuarve forca të mëdha ushtarake e milicësh nga Librazhdi, partizanët e çetës ishin tërheqës. Asnjë forcë partizane të çetës nuk pësoi humbje.

Si mbaroi aksioni çeta partizane me në krye komandanti Reshit Çollaku u nisën me itinerarin Debrovë-Bishnicë-Shën Marenë të Llëngës. Komandant Reshiti bën konkluzionet e këtij aksioni të suksesshëm. Falënderoj të gjithë pjesëmarrësit në këtë luftim si: Selami Pambuku, Riza Balliu, Llazi Kokoneshi, Shefki Piskupati, Vesel Selca Beçe Palla e tjerë.

Forcat armike që sulmonin në Jugperëndim të Pogradecit për të mposhtur kryengritësit partizan

deri në Velçan, të trembur nga goditjet që mund të jepte populli i armatosur të Mokrës, nuk ecën asnjë hap më tutje. Duke shfrytëzuar goditjen e armikut, çeta partizane e Mokrës, Gores dhe Oparit e rrethuan me shpejtësi kompaninë e armikut që po terrorizonte popullin e Velçanit. Të goditur nga jashtë unazës së rrethimit prej çetave partizane dhe nga brenda prej njësiteve guerile, fashiste u detyruan të dorëzoheshin pa ndonjë qëndresë të madhe. Me këtë humbje armikut iu hoq mundësia të bashkëpunonte me kolonën që marshonte në drejtim të Slabinjës-Çezma e Vogël-Llëngë.

Sipas një dokumenti arkivor, forcat që operonin në Luginën e Shkumbinit, duke marshuar nga Përrenjasi në zemër të Mokrës, batalioni i 7-të i karabinierisë dhe kompania e 11-të e regjimentit të 225-të divizionit “Aeraco” u hodhën në sulm kundër çetës partizane dhe forcave vullnetare të Mokrës, që mbronin rajonin Çezmë e Vogël-Llëngë.

Më 8 nëntor 1942, çeta partizane e Mokrës që nga pozicioni që kishte zënë e theu armikun. Për rreth 5 orë rresht luftimet u zhvilluan me sulme e kundërsulme deri sa forcat e armikut u detyruan të ndalin sulmin e mëtejshëm. Nga sulmet e një pas njëshme të çetës partizane kundër forcave armike të cilat natën i tërhoqin repartet dhe me 9 nëntor i përqendrojnë në Pogradec dhe Korçë.

Sipas Zërit të Popullit më 22-23 nëntor 1942: “Në Mokër, ndërsa çeta Partizane në komandën e Reshit Çollakut është në vëzhgim e sipër në një zonë ku armiku nuk guxon të hyjë veçse atëherë kur është në numër të shumtë, takoi një grumbull ushtarak italianë të armatosur deri në dhëmbë numri i të cilave arrinte 100-170 veta.

Përnjëherësh çeta partizane e sulmoi në të grumbull, duke vrarë 4 prej tyre dhe duke plagosur disa të tjerë pas një luftimi të rreptë, në të cilën ushtarët fashistë përdorën edhe top, fuqitë e armikut u tërhoqën të shpartalluar.”

Në këtë aksion të udhëhequr me mjeshtri ushtarake nga Heroi i Popullit Reshit Çollaku u dalluan: Risto Jani Bitro, Llazi Kalija, Ramadan Mani, Pasho Kullolli, Ibrahim Piskupati, Shaban Kullolli, Seit Sula, e etj.

Në një dokument arkivor ku Kuestura e Korçës bën një njoftim për një aksion të fuqishëm që bën çeta e Mokrës të udhëhequr prej Reshit Çollakut që mban datën 8 nëntor 1942.

“Kam nderin t’ju bëjmë të ditur se komanda e kompanisë KKMM Isterna na ka njoftue se prej brumi ende të pa vërtetueme është shënuar që një bandë prej 12 të armatosur kanë qenë të grumbulluar me 25 të muajit të kaluar në katundin Pleshisht të Komunës së Trebinjës me qëllime akoma të paditura. Të mësipërmit kanë qenë të kryesuar nga të arrestuarit e njohur i Reshit Çollakut ku kanë tërhequr prodhimin e të dhjetave që ishte e grumbulluar në atë anë, pra në Pleshisht të komunës së Trebinjës dhe ua kanë shpërndarë popullit sidomos e atyre të çezmës së Vogël që u janë djegur shtëpitë. Rebelët kanë qenë të armatosur të gjithë me armë luftarake dhe pushka automatike. Mbas informatave që jepej me rezerva i kemi kërkuar komandës shpjegime për vërtetësinë, ose jo të saj, të na dërgojnë me detaje rezultatit e veprimeve të zhvilluara dhe aktivitetin e gjerë. Me të na mbërritur do t’ju paraqesim.”


Ndërkohë Komuna e Trebinjës me shkresë, nr.41. Res datë 30m.b. na njofton se me datën 27 të muajit të kaluar kanë shkue në katundin Trebinjë të arriturit. Reshit Çollaku të shoqëruar prej shumë të arriturit të tjerë dhe kanë marrë grurin e të dhjetarit. Gruri i marrë nga bandat gruri prej 100 kv është transportuar prej tyre në dy ditë rresht në drejtim të katundeve Çezmë e Vogël dhe Llëngë”.

KUESTORI T.S.TJ

Një dokument tjetër arkivor bën fjalë për një njoftim i komandës së lartë të forcave të Armatosura me qendër në Korçë për veprimtarinë e çetës partizane së Reshit Çollaku dhe për krahjen e saj nga populli që mban datën 16 tetor 1973 ku shkruhet: “Pozita e rebelëve në fshatin e Velcanit Mokër nga të cilët janë sulmuar stacionet CCRR dhe sekte e komunave rezulton e konsulton se krerët kryesore (Reshit Çollaku) në bashkëpunim me bandat e vogla (njësitë) kanë organizuar për të mbrojtur një zonë të gjerë me territor malor të cilët e zotërojnë popullaritetin, kanë tani bindje të plotë mbi mungesën e autoritetit shtetëror dhe rebelët pretendojnë se kanë ndërtuar bërthamën e parë të Shqipërisë së pavarur që siç deklarohet ta mbrojnë deri në pikën e fundit të gjakut” (AQSHP 260 V143D50 sek I DIV DZEZO).

-Luftimet e çetës partizane dhe njësiteve guerile në Mokër të komanduar nga Heroi i Popullit Reshit Çollaku, flisnin qartë për një shkallë të lartë që po merrte Kryengritjen e Armatosur në Shqipëri. Këto luftime e pasuronin më tej përvojën e luftës nacionalçlirimtare. Në luftimet e çetës partizane kundër një armiku në Mokër u realizuan gërshetimi më i mirë i sulmit kundër një përqendrimi forcash armike me sulmet në pritë. Këtë bënë atë që komanda e Lartë e Forcave të Armatosura italiane të deklarohet se në Mokër ishte “ndërtuar Bërthama e Parë e Shqipërisë së Pavarur” pra Mokra ishte çliruar”.

Në informacionin e brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për veprimtarinë e luftëtarit të paepur antifashist të Reshit Çollakut dhe për aftësinë e tij organizative. (vijon faqe 12)







Lapidari në Pleshisht kushtuar ngritjes së Çetës

(vijon nga faqja 11)

(Tiranë ! shkurt 1943 midis të tjerash lexohet: "Kapo i një çete me 600 veta të armatosur që vepronin në zonën e Mokrës ish nëntogeri i këmbësorisë në 1939 dezertoi duke shkuar jashtë Atdheut në Beograd. Në vitin 1941 (gusht) do të jetë kthyer fshehurazi në Shqipëri. Ka kryer deri tani akte të shumta brigande dhe ka arritur ta nxjerrë zonën e Mokrës nga çdo influencë e autoriteteve kushetuese. Është një nga kapobandat më të rrezikshme si për egërsinë e demonstrative ashtu dhe për aftësinë organizative" (AQSH, RPSH F263 viti 1942 D507 f 125).

Me sa më sipër shkruar në zonën e Mokrës dhe rrethin e nuk vepronte më shteti dhe pushteti fashist italian dhe shërbëtorët e tyre të bindur maçokë. Atje vepronin vetëm Këshilli Nacionalçlirimtar Krahinor dhe Këshilli nationalçlirimtarë të fshatrave si dhe çeta partizane e Mokrës. Pra ky ishte dhe çlirimi i parë i Mokrës.

### ASGJESIMI I ARMIKUT NË SNOSËM E BULCAR

Në Snosëm në thellësi të krahinës së Verçës fashistët kishin ngritur postën xhandarë. Qarku i Korçës në bashkëpunim me atë të Elbasanit porosiste çetat partizane që të asgjësohej sa më parë kjo postë.

Kjo detyrë ju ngarkua çetës partizane të Mokrës me komandant Heroin e Popullit Reshit Çollaku e cila më 30 janar 1943 e rrethon postën dhe u bën thirrje armiqve në gjuhë italiane të dorëzoheshin por ata nuk pranuan Lufta vazhdoi.

Atë kohë komandantit Reshit Çollakut i erdhi njoftimi se një kolonë e gjatë ishte parë në të dalë të Gramshit për në drejtim të Snosmit me një fuqi prej 260 ushtarë, mike e xhandarë që do tu vinin në ndihmë forcave të rrethuara. Njoftonin për këtë qarkorin e Korçës i cili i dërgon në mbështetje dhe çetat Gore-Opar të cilat mbërrinë në Snosëm në mbrëmjen e 31 Janarit. Me ardhjen e tyre, numri i forcave partizane kalonte 250 luftëtarë.

Komandanti Reshit Çollaku mbledh menjëherë shtabet e çetave vendosi ndarjen e forcave partizane. Çeta e Mokrës dhe Oparit, u la të mbante në rrethim të plotë postën e Snosmit. Tre çetat e tjera ti zënë pritë kolonës armike që po i afrohej Verçës. Afrimi i forcave partizane në vendin e zënies së pritës u bë i shpejtë dhe i maskuar, duke mos ngjallur asnjë dyshim. Kur forcat armike, u futën në dorën e pritës mbi ata u hap zjarr. Goditja e befasishme në fillim i hutoi fashistët, por pastaj duke qenë të armatosur mirë, zunë pozicione mezhdave, hendeqeve e gurëve.

Armiku, me përqendrim zjarr, mudohej të siguronte epërsi në kundërsulm, për të penguar të paktën sulmet partizane dhe të zgjaste kështu, sa të ishte e mundur më tepër kohën e qëndrësës, duke shpresuar në ndihmat që mund ti vinin nga Gramshi. Por instinktivisht, që nga fillimi e deri në fund, mbeti në duart e partizanëve, që nuk i lirin armikut asnjë çast pushimi. Armiku, me gjithë përpjekjet, s'mundi të përparonte e as të lëvizte kundër nga pozicionet e fillimet partizanët, duke qëlluar pareshtur kundër tyre i mbanin të gozhdur në vend.

Thirrje për dorëzim, fashistët iu përgjigjen me dendësimin e zjarrit, duke dhënë shenja të tërheqjes. Atëherë komandanti i çetës partizane Reshit Çollaku hodhi në luftë rezervat, që deri atëherë, i kishte mbajtur të paprekshme. Njëkohësisht dha urdhër të hapej zjarr në të gjitha drejtimet. Me forcat partizane tani ishin bashkuar dhe njësitë guerile të Snosmit, Sojnikut, Llënga, Velçani që prej kohësh kishin zënë shtigjet, që plotësonin rrethimin e armikut. Ky veprim ishte e papritur për forcat e armikut. Tym e flakë kudo. Pushka partizane krisi dhe prapavijat e armikut andej nga armiqtë mbaheshin sytë në pritje të ndihmave. Pas 8 orësh luftime të përgjakshme deri dhe hedhje bombash dore, fashistët ngritën duart 178 ushtarë, karabinierë e milicë bashkë me komandantin e tyre u zunë robër. U kapën 130 pushkë, disa mitraloza, automatikë e revolverë, veshmbathje e barna mjekësore dhe pajisje të tjera ushtarake. U zhduk pra ajo strofull fashiste, një shkurti e gjeti atë zonë të lirë.

Aksioni Snosëm-Bulcar çoi në çlirimin e plotë të zonës së Verçës. Që nga ajo kohë e deri në çlirimin e rendit, fashistët e nazistët nuk shkelën më në këtë vend.


Me 2 shkurt 1942 në Snosëm në sheshin përpara ishte postës së Karabinierisë, u mblodhën të gjithë robërit e zënë në luftën e Buçarit e të postës Komandanti i çetave partizane Heroi i Popullit Shqiptar Reshit Çollaku u foli atyre në gjuhë italiane dhe shërbëtorët e bindur ndaj tyre foli dhe për gjendjen ndërkombëtare dhe më në fund u bëri thirrje atyre thirrje të bashkëpunonin me formacionet partizane, shumë prej tyre iu përgjigjen thirrjes.

At-Dhimitër Kokoneshi i cili me njësitin e tij mori pjesë në luftën Snosëm-Bulcar ka thënë:

"Reshit Çollaku ishte trim i madh, jo i rrëmbyer por i urtë dhe i matur. Nuk i trembej luftës. Kishte kulturë të gjerë evropiane. Ishte oficer i kompletuar me të gjitha cilësitë e një ushtaraku të lartë" (U.T. Gazeta "Mokra" shkurt 2001).



Busti i Reshit Çollakut në Pogradec



## Qyteti ilir i Pelionit, krenaria e Mokrës

### Flet Neritan CEKA

Që në vitin 1948, nga Hasan Çela, u evidentua Selca e Poshtme në historinë e trashëgimisë, me të tjerat Berat, Butrinti e tjera. Në vitin 1967 muzeu i Pogradecit bëri gërmimet e para tek varrezat e Selcës, tek vendi si teatër.

Në vitin 1968, filluan gërmimet e gjëra, në drejtimin e një ekipi dhe deri në vitin 1972 u zbuluan mbi 70 objekte, bronzit, bakri, qelqi, argjendi, dhe u dërguan në muzeun kombëtar, ku janë të ekspozuara.

U zbuluan 5 varret e Selsës Poshtme, që ishin të shekullit 5-të para Krishtit. Për këtë sqarojmë:

**Varri parë**, dhe mbreti, me 8 shkallë poshtë, varri i mbretit Monaur, bëri lart. Varri lart ka pasur edhe varrin e mbretëreshës së tij. Kjo starton në vitin 350 para Krishtit, janë të zgjedhura me ata të maqedonasve. Kanë qenë mbretërit Bradhyl, Kliti. Në luftë me maqedonasit, kanë qenë.

Në vitin 335, Aleksandri i Madh, sulmoi Pelionin, por u mund dhe u tërhoq, sepse i erdhi në ndihmë mbreti Glankia. Por pas disa ditësh i gjeti në befasi, dhe i sulmoi, ku

i mundi, i theu.

**Varri Nr 2** më madhështori, i vitit 280 para Krishtit.

**Varri Nr 3** dy lartësi shkallë, për aktivitet, dhe trupa mori lirinë.

**Varri Nr 4** më madhështori, neoni i ngjante trupit romak i ndërtuar në vitin 200 para Krishtit, këtu mbyllet cikli i varreve të Pelionit. Pas kësaj nuk flitet. Kanë shkuar drejt bregdetit. Këtu mbyllet cikli i Bardhytit të ri.

Në vitin 250-të para Krishtit digjen kufomat. Varri i 3-të kalon kur u dogjën kufomat.

Nga teatri antik, i ngjan atyre te Italisë Jugore, të ngjashme me atë të Finiqit e tjerë. Dy udhët për të dërguar materiale. Ka reliev bronzit, Ero-s si aktar, simbol i lashtë

**Varri i VI-të**. është 230 vjet para Krishtit, i tipit romak, 100 metra i gjatë është shënuar emri "MEKO", mjeti i punës dhe dalta e punës, mbishkrimi EPO-s përbri, i lartë 6-7 centimetra, cilëson më pak të ulët. Këtu janë varret vetëm mbreti jo mbretëresha Në vitin 250-199 para Krishtit ishin romakët e kishin pushtuar Pelionin. Ka një varr të vetëm, dhoma e gjumit me afresk, është përdorur si banesë në shekullin IV pas Krishtit, janë shkatërruar vlera të veçanta.

**Varri i 5-të**. është poshtë varrit të mbretit, të mesëm. i ngjan varrit të Filipit II-të maqedonas. Është një shtrese të pasur, jo i mbretit. Ky qyteti i pelionit, është në një pozicion të veçantë dhe përballë nga Akropoli, mbi 840 metra mbi nivelin e detit. -Poshtë qytetit me zejtarë, popullimi i thjeshtë. - varret monumentale -Lagje e dytë e qytezës shtresa e mbretit.

Pse është ndërtuar këtu Pelioni? -Lugina e Shkumbinit (Genusit) mbizotëron. Lidhja e tyre Durrës -Apolloni-Maqedoni -Vend në qytetin e Selcës, Vend mbretëror, dhe një klimë e verore shume e mirë.

Propozimet: -Të hapet, të pastrohet, një autonomi lokale -Të bëhet inventari nga qeverisja vendore -Të lejohet e jete si park nga shteti. -Pas këtij viti ti kalohet komunës për përkujdesje, pastrami, vizitorët, ciceroni i thjeshtë.

-Të shërbejë për kulturë shkencore -Në të kanë punuar gjatë vitit 2012. - Periudha e lartë njerzore mbetet krenaria e brezave tanë.

\* Marrë me shkurtime nga Zenun FERRO, e realizuar gjatë vitit 2012, e transmetuar nga TV PLANET 19 janar 2013

